# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7793 E enjte 14 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE



## Greta Thunberg dhe rinia për klimën

Është fjala për gjimnazisten 16-vjeçare suedeze, Greta Thunberg, e cila ka mbi një vit që është shfaqur si superylli i lëvizjes së re për klimën që ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



## Për taksa pa stërkëmbësha

Jo pak sipërmarrës sot shprehen se "nuk guxon të bësh një plan afatgjatë investimi, pasi qeveria i ndryshon ligjet për taksat aq shpesh, sa vë në pikëpyetje ...

Vijon në faqen 21

NDERTIMET PA LEJE, FONDI I RI FINANCIAR PER PAGESEN E TOKES SE ZENE

# EMRAT, 750 PRONARET QE NDAJNË 5 MILIONE DOLLARE

Përfituesit e kompensimit në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë e Vlorë. Si bëhet aplikimi për të marrë paratë dhe dokumentet që duhen dorëzuar



*(Në foto)* Ndërtime pa leje

Në faqet 7-9




"Gjithçka varet nga vullneti politik"

# SHBA: Do krijojmë SPAK që politika të mos mbrojë interesin e grupeve kriminale

Qeveria organizon konferencë në Tiranë kundër kanabisit, në Kapshticë kapet 1 ton në kamion

TIRANË-Ulet në mënyrë drastike kultivimi dhe trafikimi i kanabisit në Shqipëri. Policia e Shtetit në bashkëpunim me GDF kanë publikuar raportin me shifrat e kultivimit dhe sekuestrimit për vitin 2018. Nga raporti rezulton se viti i kaluar shënoi nivelin më të ulët të kultivimit të kanabisit në vend. Zyrtarët e lartë të Guardia Di Finanza-s ...

Në faqen 15

KRIMI I GARDISTIT

## Vrau gruan dhe telefonoi policinë: Dyshoja se takonte meshkuj të tjerë

Në faqen 14

KRYEMINISTRI

## Rama: Vendimi për Dajtin u mor nga kriminelë me kostum, do ta zhbëjmë

Në faqen 4

BOTIMI I RI

## Azis beu dhe Hëna, një histori nga vitet 1930 në librin e Bashkim Hoxhës

Në faqen 18

ARSIMI

## Vendimi i MAS, testim për nxënësit e klasave të pesta, zbardhen 3 lëndët

Në faqen 11

"16 SHKURTI"



## Protesta para Kryeministrisë, Basha: Na ndihmoni ta hapim atë derë

Në faqen 3

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese miraton draftin. LSI: Rrezikohen konflikte

# Tokë me 7501, ndahen tapi për 200 mijë pronarë

*Nisma e qeverisë: Procesi mbyllet brenda 6 muajsh. Ja kush përfiton*

Personat që kanë përfituar tokë bujqësore me ligjin 7501 do të pajisen me certifikatë pronësie brenda 6 muajve nga miratimi në parlament i ndryshimeve ligjore që kaluan dje "testin" e deputetëve në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. Kur kanë kaluar më shumë se 25



vite që kur u shpërndanë tokat me ligjin 7501 dhe atë për ndarjen e tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore, gjysma e titujve të pronësisë nuk janë të regjistruar në hipotekë. "Janë 400 mijë akte të marrjes së tokës në pronësi dhënë fermerëve. Të regjistruar në Zyrën ...

Në faqen 6

# PROTESTAT
## TAKIMET

Bardhi: Nëse cenohet lëvizja drejt Tiranës, protestuesit do t'i heqin pengesat

# Protesta, PD: Mos bllokoni rrugët. LSI: S'do të ketë dhunë

## Rama: Jo konfrontim mes qytetarëve dhe institucioneve


Një nga protestat e PD-së

Valentina Madani

Opozita i bëri dje thirrje qeverisë që mos të bllokojë rrugët ditën e shtunë, kur qytetarë nga rrethet do të mblidhen në protestën para Kryeministrisë. Sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, deklaroi se nëse do të bllokohen dy akset kryesore kombëtare që lidhin Tiranën me veriun dhe me jugun e vendit, atëherë protestuesit do t'i heqin me dhunë pengesat e vëna nga policia. Z.Bardhi përmendi shembullin e zonës së "Astirit", ku banorët protestues kundër projektit të 'Unazës së Madhe' larguan me dhunë makineritë e kompanisë private që do të ndërtojë rrugën. "Po paralajmërojmë që tani çdo kompani ndërtimi që të mos nxjerrin në rrugë asnjë makineri dhe të mos bëjnë asnjë veprim që cenon lëvizjen e lirë të protestuesve drejt Tiranës! Përndryshe, fati i tyre është i njohur! Qytetarët do t'i heqin pengesat me mënyrat e tyre, njësoj siç bënë banorët e 'Unazës së Re'! Shqiptarët do të jenë në Tiranë të shtunën. 16 shkurti është protesta që do t'i japë fund një pushteti të blerë me votat e krimit, një qeverie të kapur në vjedhjen e zgjedhjeve dhe në vjedhjen e qytetarëve të saj", theksoi sekretari i përgjithshëm i PD-së. Ai u shpreh se bllokimi i akseve rrugore nuk t'i pengojë qytetarët të bashkohen me opozitën. "Teknikisht nuk ka asnjë motiv për bllokimin e autostradës dhe rrugëve të tjera kombëtare. Teknikisht, nëse do të ishte vërtet e nevojshme dhe jo një vendim në kushtet e panikut, qytetarët duhet të ishin lajmëruar disa ditë më parë, siç është vepruar në raste të tjera", tha z.Bardhi.

**DEKLARATA**

LSI përmes deputetit Luan Rama garantoi dje se protesta e opozitës më 16 shkurt do të jetë paqësore dhe nuk do të ketë shfaqje të dhunës. Zëvendëskryetari i LSI-së bëri të ditur se qytetarët do të dalin në protestë vetëm për të kundërshtuar, sipas tij, qeverinë e korrupsionit dhe lidhjet me krimin. Ai tha se do jetë dita e fitores së qytetarëve mbi të keqen. "Protesta e 16 shkurtit nuk është një konfrontim mes qytetarëve dhe institucioneve të shtetit, por është fillimi i luftës së qytetarëve kundër të keqes. Është demonstrimi i forcës qytetare përballë papërgjegjshmërisë së qeverisë, është manifestimi solidaritetit dhe angazhimit qytetar përballë krimit, korrupsionit, trafiqeve së qeverisë që është bërë pengesë në procesin e integrimit evropian të vendit. Prandaj edhe njëherë duke i ftuar të gjithë qytetarët të jenë pjesëmarrës në këtë protestë, dëshiroj të garantoj se ajo do të jetë një protestë force e qytetarie, revolte e shpirtit qytetar përballë arrogancës, dhunës së qeverisë, por nga ana tjetër sipas modelit të më të mirë që demonstruan studentët shqiptarë me protestën e tyre. Edhe protesta e 16 shkurtit do të jetë demonstrim force, por edhe manifestim qytetarie", tha z.Rama. Më tej ai shtoi: "Ejani të jemi bashkë në 16 shkurt për të filluar përfundimisht rrugën e lirisë dhe integrimit europian të Shqipërisë. 16 shkurti është dita e shpirtit dhe solidaritetit qytetar, është dita e fitores së qytetarëve mbi të keqen, që është personifikuar tek qeveria e krimit dhe kryeministri i qeverisë së krimit".


Luan Rama


Gazment Bardhi

**GAZMEND BARDHI**

"Po paralajmërojmë që tani çdo kompani ndërtimi që të mos nxjerrin në rrugë asnjë makineri dhe të mos bëjnë asnjë veprim që cenon lëvizjen e lirë të protestuesve drejt Tiranës, përndryshe fati i tyre është i njohur! Qytetarët do t'i heqin pengesat me mënyrat e tyre, njësoj siç bënë banorët e Unazës së Re! Shqiptarët do të jenë në Tiranë të shtunën!", theksoi z.Bardhi.

**LUAN RAMA**

"Protesta e 16 shkurtit nuk është një konfrontim mes qytetarëve dhe institucioneve të shtetit, por është fillimi i luftës së qytetarëve kundër të keqes. Është demonstrimi i forcës qytetare përballë papërgjegjshmërisë së qeverisë, është manifestimi solidaritetit dhe angazhimit qytetar përballë krimit", tha z.Rama.

"Të protestojmë, Europa një realitet i largët"

## Protesta, Mediu: Të mos ulim kokën para një qeverisjeje hajdute

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, zhvilloi dje një takim me strukturat në Fier, duke u bërë thirrje qytetarëve të ngrihen në protestë pa dallime politike. Sipas tij, ka ardhur koha që shqiptarët pa dallim politik në datën 16 shkurt të ngrihen kundër së keqes, ndërsa sipas tij, Europa është kthyer në një realitet të largët, të paprekshëm. Mediu tha se qeveria e Ramës i ka vendosur shqiptarët para dy zgjidhjeve, të pranojnë mjerimin, ose të largohen. "Në emër të familjeve tona, në emër të së ardhmes tonë nuk mund të pranojmë të ulim kokën përballë një qeverisjeje, e cila ka cenuar çdo lloj të drejte tonën, lirinë e votës, është e lidhur me krimin dhe trafikun e drogës dhe po e çon Shqipërinë në atë drejtim që asnjë nga ne nuk e dëshiron duke shkatërruar të ardhmen e Shqipërisë dhe shqiptarëve", deklaroi z.Mediu. Kreu i republikanëve tha se sot liria është kthyer në një koncept pa vlerë, ndërsa sipas tij sfidat kombëtare sidomos në Kosovë janë me të vështira, pasi sipas tij, qeveria shqiptare po tregohet e papërgjegjshme dhe e ka kthyer në pazar.



**ARSYET**

Z.Mediu tha se ka ardhur koha që shqiptarët pa dallim politik në datën 16 shkurt të ngrihen kundër të keqes, ndërsa sipas tij Europa është kthyer në një realitet të largët, të paprekshëm.



## Berisha: Terror administratës. Braçe: Kërkova të bëhet puna

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, sipas të cilit zv.kryeministri Erjon Braçe ka ushtruar terror në zyrat e administratës në Fier. "Ka më shumë se një javë që në zyrat e institucioneve në Fier vjen dhe bën inspektim vetë Erjon Braçe, duke bërë 'show' se gjasme të rritet aftësia në shërbimet publike në administratë, por tjetër gjë luhet. Nga Tirana sot (dje) vjen një email nëpër drejtoritë e kuadrit, ku kërkohen të gjitha dosjet e nëpunësve të administratës në Fier, në të gjitha drejtoritë rajonale, kjo për arsye të verifikimit për çdo punonjës se kur ka hyrë në administratë, kush e ka sjell mik i kujt është dhe kujt force politike i takon, pra qëllimi i këtij inspektimi i Braçes është selektimi i atyre që kanë ngelur dhe zëvendësimi i tyre me militantët e fushatës elektorale që vjen në qershor dhe vijnë e na nxjerrin propaganda politike për emërime mbi bazë meritokracie të rastit të asaj vajzës që me demek ishte ekselente", - thuhet në denoncim. Por z.Braçe iu përgjigj ish-kryeministrit duke thënë se ka filluar të shkojë zyrë më zyrë duke kërkuar të bëhet punë. E gjitha kjo, sipas tij ka një qëllim, shërbimin ndaj qytetarit. "Ky nuk është terror, kjo është përgjegjshmëri ndaj detyrës dhe shërbimit publik ndaj qytetarit. Vertikalisht, nga unë deri tek i fundit nëpunës që paguhet nga taksat e qytetarëve. Ti Sali Berisha nuk hyn këtu. Ti ke gjithë të drejtën të jesh i papërgjegjshëm!", shprehet z.Braçe.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Kreu i PD-së fton qytetarët e Burrelit: 16 shkurti, referendumi më i madh popullor

# Protesta para Kryeministrisë, Basha: Na ndihmoni të hapim atë derë

## "Pas gardhit të policëve është hajduti"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha ishte dje në Burrel në takim me simpatizantët demokratë dhe qytetarët, të cilët i ftoi që të merrnin pjesë në protestën e 16 shkurtit para Kryeministrisë. Z.Basha paralajmëroi se qëndresa do të vazhdojë deri në largimin e Ramës nga qeveria. "Falë bashkimit tuaj, i cili do të jetë më i madhi që ka dëshmuar populli shqiptar, një standard i ri evropian do të vendoset. Çdo qeveri që vjen pas datës 16 do t'i bëjë llogaritë me popullin. Siç jeni mbledhur sot, (dje) siç u mblodhët në protestën madhështore para ditë ditësh, ashtu të bashkuar të derdheni në Tiranë, me drejtësinë e kauzës popullore në zemër dhe me vendosmërinë për të mos u larguar pa shembur sistemin e kalbur që po ju varfëron dhe vjedh ditë për ditë. Le të vërshojë sovrani në rrugët dhe sheshet e Tiranës, të shtunën në orën 11 në referendumin më të madh popullor që do t'i japë fund kësaj qeverie bandite. Është një bashkim europian dhe kushtetues, për t'i dhënë fund njëherë e mirë, këtij sistemi të kalbur që është vetëm një grup njerëzish", deklaroi z.Basha. Gjatë takimeve kreu i PD-së theksoi se familjet shqiptare po varfërohen nga politikat e ndjekura prej qeverisë "Rama". Ai akuzoi se qeveria qëndron në pushtet me paratë e krimit. "Me 16 shkurt do t'i japim fund kësaj qeverie bandite. 16 shkurti është bashkimi popullor kundër vjedhjes, hajdutëve të Shqipërisë, kundër vjedhjes së zgjedhjeve dhe të ardhmes se shqiptareve",-deklaroi kreu i opozitës. Referuar kordonit të policisë që do të jetë para Kryeministrisë në protestën e së shtunës, lideri demokrat tha se matanë tij janë hajdutët, ndërsa përballë kanë popullin. Ndonëse në pushtet Basha tha se do të vijë përmes votës së lirë, shqiptarët i ftoi të bëjnë rezistencë deri në rrëzimin e qeverisë. "PD do vijë në pushtet me votë. Të shtunën në anën tjetër të gardhit të policisë është kryehajduti që është kapur duke vjedhur paratë tuaja, votat tuaja... ndaj të shtunën bota do ta shohë se ku e ka katandisur shtetin Edi Rama, që mbron hajdutët dhe vjedhjen, ndaj bashkimi i 16 shkurtit ka forcë e fuqi mbi parlamentin dhe qeverinë e hajdutëve, është një bashkim europian e kushtetues për t'i dhënë fund një herë e mirë këtij sistemi të kalbur",-deklaroi z.Basha. Zgjidhja sipas tij për gjendjen e rënduar që po kalon vendi si pasojë e keqqeverisjes mund të vijë vetëm përmes planit ekonomik të Partisë Demokratike, të cilin e ndau edhe me banorë e përfaqësues të biznesit të vogël në Burrel. Basha edhe një herë ripërsëriti se pushteti nuk mund të jetë i atyre që kanë vjedhur votat. "Me 16 shkurt do t'i japim fund kësaj qeverie bandite. 16 shkurti është bashkimi popullor kundër vjedhjes, hajdutëve të Shqipërisë, kundër vjedhjes së zgjedhjeve dhe të ardhmes se shqiptareve. Taksat e larta, çmimi i lartë i energjisë dhe e naftës nuk janë thjesht rritje, por kjo është vjedhje. Këta janë kapur duke vjedhur studentët, janë kapur duke vjedhur edhe votat dhe këtë e tregoi 'Zëri i Amerikës'. Sot shqiptarët e kanë parë se këta kanë dalë lakuriq, sepse u kapën duke vjedhur,", u shpreh kreu i PD-së.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Burrel

**FTESA**

"Ju ftoj të gjithëve më 16 shkurt, nga gardhi matanë policëve është hajduti, ndërsa pjesa këtej është pala e vjedhur. Na ndihmoni të hapim atë derë. Të bashkohemi të gjithë për Shqipërinë si gjithë Evropa. Hajdutët duhet të shkojnë në burg. Ky është thelbi i ditës së shtunë", - theksoi z.Basha.

**POLICIA**

Policia e Shtetit dy ditë më parë i bëri apel opozitës që në protestën e së shtunës të shmangin retorikat, të cilat nxisin veprime kundër rendit e qetësisë publike. Policia e Shtetit shprehu shqetësimin për përfshirjen në tubimin e organizuar të individëve me precedentë penalë.

### Dy kërkesat e PAA-së për kreun e opozitës

## Zgjedhjet, Duka: Nuk e firmos platformën e bashkëpunimit me PD-në



Partia Agrare Ambientaliste e refuzon Platformën e Bashkëpunimit që Partia Demokratike e propozoi për aleatët e saj. Sipas kreut të PAA-së Agron Duka, Basha, më herët duhet të plotësojë dy kërkesa thelbësore. "Një nga pikat që ne na ndan dhe e kemi theksuar gjatë gjithë kohës është Kodi Zgjedhor, reforma zgjedhore, gjë e cila preket shumë shkarazi në platformën e Bashës. E dyta, duam që në një nga pikat e reformës të jetë e theksuar zhvillimi i bujqësisë në të ardhmen",-deklaroi z.Duka për Ora News. Nëse PD heziton në plotësimin e dy kërkesave, Partia Agrare do të dalë zyrtarisht jashtë koalicionit të opozitës. Sipas Dukës, kjo nuk do të thotë që kjo forcë politike do bashkëpunojë me mazhorancën. "Absolutisht jemi jashtë koalicionit, por gjithmonë jemi në opozitë me mazhorancën, sepse edhe nga mazhoranca jemi të pakënaqur me mënyrën se si e shikon zhvillimin e bujqësisë. Mendojmë se bujqësia dhe blegtoria nuk shihet si prioritet, por shihet si një sektor anësor",- u shpreh z.Duka. Përtej riciklimit në dukje të një kize brenda opozitës, Partia Agrare Ambientaliste, mbështet dhe do të jetë pjesë e protestës së 16 shkurtit. "Ne do të jemi në protestë së bashku me opozitën, së bashku me qytetarët shqiptarë",-tha kreu i PAA-së. Platforma e bashkëpunimit e propozuar nga Partia Demokratike, u kërkon të dalin në një koalicion me kandidatë të përbashkët në zgjedhjet e ardhshme.



### 16 shkurti, Salianji: Të çlirojmë Shqipërinë nga krimi

Deputeti i PD-së Ervin Salianji ftoi dje shqiptarët që me 16 shkurt të çlirojnë Shqipërinë nga krimi. Ai renditi dje kontrabandën e drogës si një nga arsyet kryesore, pse shqiptarët duhet t'i bashkohen opozitës së bashkuar. Salianji shkruan në 'Facebook' se propaganda nuk e mbulon dot dështimin, ndërsa përgënjeshtron edhe deklaratat e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri dhe pasardhësit të tij, Sandër Lleshaj. Deputeti demokrat krahas deklaratave, rendit edhe faktet, rastet e shqiptarëve të arrestuar brenda dhe jashtë vendit me aktivitet kriminal. "Propaganda që nuk mbulon dot dështimin, qeveria e ka humbur kontrollin në territor njësoj, siç ka humbur logjikën! Në 16 shkurt të çlirojmë Shqipërinë nga krimi, në këmbë për Shqipërinë",-deklaroi deputeti i PD-së.

### Protesta, Duma: PD merr përgjegjësi për çfarë do të ndodhë

Deputetja e PD, Grida Duma deklaroi dje në News24, se kohëzgjatja e protestës së 16 shkurtit do të jetë në varësi të një vendimmarrje nga opozita. Duma u shpreh e bindur për pjesëmarrjen masive në protestë dhe se sipas saj opozita kërkon krijimin e një qeverie tranzitore pa Edi Ramën. "Sa do të zgjasë protesta pritet të merret vendimi dhe do bëhet me dije. Mendoj se hermetizimi është një strategji normale. Unë jam e bindur që do kemi një pjesëmarrje të merituar për atë që presin shqiptarët nga opozita. PD ka marrë gjithmonë përgjegjësinë për protestat e veta dhe mban përgjegjësi për atë që do të ndodhë. A duhet të jetë protestë e qetë? Duhet të jetë një protestë e fortë dhe e qartë. Pra, një qeveri tranzitore pa Edi Ramën. Nëse Rama nuk largohet nuk është opsion. Ne dimë fuqinë e vetes dhe përgjegjësinë. Shoqëria shqiptare gëlon nga pakënaqësia. Nuk kërkojmë qeveri të re me mjete kriminale"- tha Duma.

VENDIMI

QEVERIA

Kreu i qeverisë deklaroi se gjyqtarët kryen një akt kriminal, duke i rivrarë 4 policët

# Rama: Vendimi për Dajtin nga kriminelë me kostum, do ta zhbëjmë

## "U ka ardhur fundi në drejtësi dhe po i bien me top"



Kryeminsitri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat



Gati 1 javë pasi Gjykata e Apelit i fali 4 dënimet përjetë Dritan Dajtit dhe duke e dënuar me 25 vite heqje lirie, ka reaguar për herë të parë edhe kryeministri Edi Rama. I vënë në qendër të akuzave të opozitës si njeriu që ka ndikuar në këtë vendimmarrje, kreu i qeverisë gjatë një takimi me banorë të Rrëshenit nuk nguroi t'i konsiderojë gjyqtarët që dhanë vendimin si kriminelë me kostum dhe me kravatë. Duke dënuar vendimin e dhënë si tërësisht kriminal, kryeministri Rama u zotua në emër të mazhorancës dhe qeverisë që drejton se do të bëjë çmos që ta zhbëjë atë. "Njerëz të ligj dhe të korruptuar, të cilët nuk janë vetëm ata, por janë plot që duke parë se u ka ardhur fundi në sistemin e drejtësisë, po i bien me top. Po kryejnë një akt kriminal, se faktikisht i rivranë 4 policët. Ne nuk do t'i ndahemi kësaj çështjeje, që ta zhbëjmë duke bërë të gjithë presionin e nevojshëm, por edhe këta gjykatës besoj nuk do t'ia dalin të shpëtojnë kaq lehtë", - u shpreh kryeministri Edi Rama. Ai shprehu keqardhje për atë që ndodhi me këtë çështje, ndërsa theksoi se kjo tregoi edhe një herë domosdoshmërinë për ta çuar deri në fund reformën në drejtësi. "Më ka ardhur keq për atë që ka ndodhur, por nga ana tjetër janë gjëra që nuk më çudisin, sepse ne kemi ndërmarrë një reformë të thellë si askush nuk e ka menduar për të pastruar kancerin nga i gjithë organizmi i sistemit tonë të drejtësisë, duke shkulur nga trupi i sistemit tumore dhe metastaza", - u shpreh kreu i qeverisë. Rama hodhi poshtë edhe çdo akuzë për t'ia faturuar atij këtë vendimmarrje të gjyqtarëve, si dhe çdo përpjekje për krijuar te qytetarët bindjen se pas këtij vendimi qëndron pikërisht ai. "Drejtësinë e drejtë e kanë penguar politikanë dhe prokurorë si këta. Më akuzojnë se Dritan Dajti kishte lidhje me mua, ndërkohë që në kabllogaramet dhe raportin e ambasadës amerikane është e shkruar se vrasësi është i lidhur me Saliun. Këtu kthehen përmbys dhe zien kazani çdo natë me gjithfarë shpifjesh dhe monstruozitetesh, duke dashur të dëshpërojnë njerëzit. Këta njerëz kriminelë me kostum dhe kravatë nuk ndalen, sepse janë mësuar 30 vjet të bëjnë të njëjtën gjë duke vjedhur qytetarët, rivrarë të vrarët dhe përdhunuar vajza të reja", - shtoi kryeministri. Në fjalën e tij para banorëve të Rrëshenit, ai theksoi se do jetë reforma në drejtësi, ajo që do u jap një herë mirë fund këtyre vendimeve. "Reformën e kemi bërë me shpejtësi të madhe, por çdo gjë ka kohën e vet. Një shtet i së drejtës nuk mund të ndërtohet sa hap e mbyll sytë. Vetingu po largon 'peshkaqenë' nga ky sistem. Në këtë fazë, reforma është pastrim dhe ndërtim i sistemit të ri, do merret me ta dhe me këdo", - tha Rama. Ndërkohë që gjatë këtyre ditëve ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj i kërkoi zyrtarisht Këshillit të Lartë Gjyqësor të nisë hetimin disiplinor për pesë gjyqtarët e Apelit të Krimeve të Rënda, të cilët më 8 shkurt të këtij viti shpëtuan Dritan Dajtin nga burgu përjetë, dhënë nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë. Gjykata e Apelit pranoi kërkesën e Dajtit për gjykim të shkurtuar, duke vendosur ta dënojnë me 25 vite burgim, ndonëse akuzohet për vrasjen e 4 policëve në 2009-ën.

**PËR OPOZITËN**

"Drejtësinë e drejtë e kanë penguar politikanë dhe prokurorë si këta. Më akuzojnë se Dritan Dajti kishte lidhje me mua, ndërkohë që në kabllogaramet dhe raportin e ambasadës amerikane është e shkruar se vrasësi është i lidhur me Saliun. Këtu kthehen përmbys dhe zien kazani çdo natë me gjithfarë shpifjesh dhe monstruozitetesh, duke dashur të dëshpërojnë njerëzit".

**KRYEMINISTRI**

"Drejtësinë e drejtë e kanë penguar politikanë dhe prokurorë si këta. Më akuzojnë se Dritan Dajti kishte lidhje me mua, ndërkohë që në kabllogaramet dhe raportin e ambasadës amerikane është e shkruar se vrasësi është i lidhur me Saliun. Këtu kthehen përmbys dhe zien kazani çdo natë me gjithfarë shpifjesh dhe monstruozitetesh".

## Kryeministri: Për rrumpallë keni PD-në, Luli vdiq të takohet me mua

Kryeministri Edi Rama e ka marrë me sportivitet protestën që ka thirrur opozita në 16 shkurt, teksa edhe në Rrëshen ai nuk ka munguar të shkëmbejë batuta e të ironizojë PD-në dhe kryetarin e saj, Lulzim Basha. Gjatë bashkëbisedimit me qytetarët, ai u shpreh se i vinte keq për njerëzit që i shkojnë pas opozitës, ndërsa ka sjellë në vëmendje disa nga lapsuset e bëra nga kryetari i PD-së, Lulzim Basha. "Ajo që mua më krijon trishtim është ideja që ka ende njerëz të zakonshëm, që u shkojnë mbrapa atyre… Si mund t'i shkosh pas Lulit?! Mua më vjen keq realisht. Një kryetar partie që thotë do bëjmë 3 qind lekë litrin e energjisë. Do thoni ju lapsus, po lapsus makina llogaritëse, lapsus kjo, ta bëjmë dhe naftën 3 qind lekë kilovatin dhe ta mbyllim këtë punë. Ne do të qeshim pak me Lulin, se s'kemi ça bëjmë. Ti e kupton vetë, aq shumë e ka përsërit atë 7 herë 7, sa po na bind edhe ne se 42 si 49 njësoj është", - tha Rama. Ndërkohë që duke shkëmbyer batuta me një qytetar tjetër, ai u shpreh se protesta ka për qëllim pikërisht të kundërtën e asaj që deklaron Basha se nuk do të takohem më me të. Rama tha se Basha do pikërisht që të ulet në një takim me të dhe të tentojë të futet në qeveri. "Më e bukura është kur tha në Krujë: Betohem para Sarisalltikut se nuk e takoj më Edi Ramën. Aq shumë do të më takojë sa betohet atje, se një njeri kur s'do të të takojë, nuk betohet, por betohet atje dhe i thotë Atij mos më lër ta takoj se vdiqa ta takoj. Dhe këta që i shkojnë mbrapa dhe i thonë 'ta rrëzojmë, ta rrëzojmë', se ai i do mbrapa që të më thotë mua 'e shef sa shumë kam', kështu që me tako, më fut dhe mua në qeveri se vdiqa. Kështu që… se këtë herë s'ka as çadër, se herën e kaluar kishte edhe një çadër, pinin edhe nga një birrë, po tani u thotë rrini atje, do jepni edhe jetën", - u shpreh më tej Rama.





## Gjylameti, debat me Daden: Po sulmohem për faje që s'i kam bërë

Kryetarja e Partisë Socialiste të Tiranës, Blerina Gjylameti, ka vijuar debatin në distancë me ish-deputeten dhe ish-anëtaren e kryesisë së PS-së, Arta Dade. Nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale, duke marrë shkas nga një artikull në median e shkruar ku ajo akuzohej për plagjiaturë në diplomën e doktoraturës, Gjylahmeti shprehet se po sulmohet për faje që nuk i ka bërë. "Sulmohem me fjalë rrugësh dhe akuzohem për faje që nuk i kam bërë kurrë. S'ka problem, jam mësuar, siç u mësove edhe ti me sulmet e padenja në adresën tënde, kur ishe këtu ku jam unë sot. Por çka ti me siguri nuk do e kishe pranuar kurrë do të ishte të sulmoheshe në nder e në dinjitet nga djali im! Unë edhe këtë e pranoj, si pjesë të një kulture të vjetër e të shëmtuar, që aq dëm i bëri PS në të shkuarën: Të gjithë kundër të gjithëve!", - shkroi Gjylameti. Më tej ajo shprehej nuk ka shanse që PS dhe Edi Rama të rrëzohen me gjoba apo kërcënime.



Qeveria emëroi dy zv.ministra të Arsimit dhe shkarkoi një zv.ministër te Bujqësia

# Ndryshimet në qeverisje, Rama bën tri lëvizje të tjera

## "Qeveria ka ndryshuar shumicën e drejtorëve"

Vala e ndryshimeve në qeveri të ndërmarra që në fund të dhjetorit të shkuar si reagim për protestën e studentëve nuk ka përfunduar akoma. Pas ndryshimit të shumicës së anëtarëve të kabinetit qeveritar, kreu i qeverisë po vijon edhe me ndryshimet në nivelet e mëposhtme të qeverisjes, zëvendësministra dhe drejtorë të përgjithshëm. Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave ka miratuar dje disa ndryshime zëvendësministrash dhe që prekin dy ministri, atë të Arsimit dhe atë të Bujqësisë. Gjatë mbledhjes së djeshme qeveria miratoi emërimin e dy zëvendësministrave të rinj të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Bëhet fjalë për emërimin e Lorena Haxhiut, e cila nuk është një emër i panjohur për opinionin publik. Ajo njihet si një nga imazhet e ekranit, pasi ka prezantuar disa programe e emisione të mëngjesit apo pasdites në disa televizione. Ndërkohë që zëvendësministrja e re e Arsimit ka mbajtur edhe postin e drejtoreshës së Përgjithshme të Shërbimit Rinor, në varësi të Ministrisë së Arsimit, para se t'i besohej posti që la vetë Besa Shahini. Zëvendësministri tjetër i emëruar dje është Redi Shtino. Ai ka formim si jurist dhe ka mbajtur deri në 2017 postin e zëvendësministrit të Arsimit, gjatë kohës kur drejtonte Lindita Nikolla. Pra, për të është një rikthim në këtë detyrë. Po gjatë mbledhjes së djeshme, qeveria ka bërë edhe një tjetër ndryshim në rang zëvendësministrash. Ajo ka liruar nga detyra zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ilir Haliaj. Këto nuk janë të vetmet ndryshme që qeveria ka bërë në nivel zëvendësministrash, pasi më parë ka bërë disa lëvizje edhe në ministri të tjera siç është edhe ajo e Transporteve dhe Energjisë. Po ashtu, Rama ka ndryshuar pjesën dërmuese të drejtorëve të një sërë institucionesh të rëndësishme. Vetëm një javë më parë u shkarkua drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Stefan Çipa, megjithëse kishte vetëm pak muaj në krye të këtij institucioni. Vendin e tij e zuri Agim Ismaili, që deri më parë mbante detyrën e Drejtorit të Autoritetit të Kontrollit Ushqimor. Në po të njëjtën ditë Stefan Çipa u emërua në krye të Entit Kombëtar të Banesave. Ndërkohë që në vend të Agim Ismailit, tek AKU u emërua ish-drejtori i KESH, Agron Hetoja. Vetë Hetoja ishte shkarkuar dy javë më parë nga pozicioni i drejtorit të KESH dhe në vend të tij u emëruar ish-drejtori i Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Benet Beçi. Ndërkohë që në vend të Benet Becit u emërua Dritan Agolli. Ndërkohë që një lëvizje e bujshme ishte edhe ajo e shkarkimit të drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve, Afrim Qendro, i cili u zëvendësua nga ish-ministrja e Sipërmarrjes, Sonila Qato. Gjithashtu, një tjetër lëvizje e rëndësishme ka qenë edhe ajo e shkarkimit të drejtorit të OST-së, Klodian Gradeci, i cili u zëvendësuar me ishdrejtorin e IMT-së së Bashkisë Tiranës, Skerdi Drenova.



Kryeminsitri Edi Rama

**ZV.MINISTRJA**

Gjatë mbledhjes së djeshme qeveria miratoi emërimin e dy zëvendësministrave të rinj të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Bëhet fjalë për emërimin e Lorena Haxhiut, e cila nuk është një emër i panjohur për opinionin publik. Ajo njihet si një nga imazhet e ekranit, pasi ka prezantuar disa programe e emisione të mëngjesit apo pasdites në disa televizione.

**ANETARESIMI**

## Shqipëria i thotë sot "po" hyrjes së Maqedonisë në NATO

Kuvendi i Shqipërisë do të votojë sot Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Me këtë rast sot në sallën e seancave plenare do jetë i pranishëm edhe kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi. Ai do të pritet më parë nga homologu i tij shqiptar, Gramoz Ruçi, në një takim dhe më pas do të ndjekë seancën ku dhe do të votohet Protokolli. Ky dokument ka marrë votën e mazhorancës dhe opozitës gjatë votimit në komisione dhe sot gjithashtu, atë pritet ta votojnë të gjithë deputetët. Shqipëria bëhet kështu një nga shtetet e para që ratifikon këtë Protokoll, duke i hapur rrugën më pas edhe hyrjes së tij në fuqi. Më parë atë e ka ratifikuar parlamenti i Greqisë. Që ky protokoll të hyjë në fuqi dhe Maqedonia të bëhet pjesë e NATO-s, duhet që ai të votohet nga të gjitha parlamentet e vendeve anëtare të NATO-s.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Realizimi i lidhjes *online* ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 9,720,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Realizimi i lidhjes *online* ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Mars 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## Meta në festimet e 100-vjetorit të themelimit të Eparkisë së Lungros në Kalabri

Me ftesë të Ipeshkvit të Eparkisë së Lungros, Imzot Donato Oliverio, Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori dje pjesë në ceremonitë zyrtare të 100-vjetorit të themelimit të kësaj eparkie arbëreshe që u zhvillua në Katedralen e Lungros (Ungrës). Presidenti Meta përshëndeti themelimin e Eparkisë së Ungrës më 13 shkurt 1919, që shënoi datën historike kur Vatikani u kushtoi një vëmendje edhe më të madhe ndjekësve besnikë të ritit bizantin në Itali, arbëreshëve, të cilët prej më se katër shekujsh i kryenin ritet e tyre liturgjike në gjuhën arbëreshe. Eparkia e Ungrës është eparkia më e madhe arbëreshe e Italisë kontinentale. 100-vjetori i themelimit të Eparkisë së Ungrës përkujton çastin më kulmor dhe më të rëndësishëm të rrugëtimit arbëresh, të cilët përpiqen sot e kësaj dite të mos humbasin identitetin kombëtar, gjuhën amtare, ritet fetare, kulturën, zakonet dhe trashëgiminë historike të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese miraton draftin për regjistrimin e tokës bujqësore

# Tokë me 7501, për 6 muaj do të pajisen me tapi 200 mijë pronarë

## *Nisma e Braçes për të lehtësuar 9 mijë familje fermerësh*

Personat që kanë për fituar tokë bujqësore me ligjin 7501 do të pajisen me certifikatë pronësie brenda 6 muajve nga miratimi në parlament i ndryshimeve ligjore që kaluan dje "testin" e deputetëve në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. Kur kanë kaluar më shumë se 25 vite që kur u shpërndanë tokat me ligjin 7501 dhe atë për ndarjen e tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore, gjysma e titujve të pronësisë nuk janë të regjistruar në hipotekë. "Janë 400 mijë akte të marrjes së tokës në pronësi dhënë fermerëve. Të regjistruar në Zyrën e Regjistrimi të Pasurive të Paluajtshme janë rreth 50% e tyre", tha Ermira Gjeçi, zv.ministre Bujqësisë. Ndërkohë, rreth 9 mijë fermerë të tjerë kanë probleme për të marrë aktin e tokës në përdorim. Për t'i dhënë zgjidhje një pjesë të problematikës, mazhoranca miratoi në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dy projektligje të propozuara nga deputeti Erion Braçe, që lehtësojnë marrjen e dokumentacionit për familjet që nuk pajisen dot me aktin e marrjen së tokës në përdorim. Por, për ish-ministrin e Bujqësisë, Edmond Panariti, çështja duhet trajtuar me kujdes dhe nisma të jetë e mirëmenduar, pasi mund të lindin konflikte. "Bëni shumë kujdes, mos fusni duart në një proces, i cili mund të gjererojë konflikte të panumërta, mund të krijojë konflikte sociale dhe mos e çoni procesin në mënyrë të sforcuar kur ai vuan nga parregullsi", tha Panariti, deputet LSI. Në thelb dy ligjet lejojnë ata fermerë që janë shpërngulur në vitet '90 nga një vendbanim në tjetrin pa u regjistruar në zyrat e gjendjes civile të marrin aktet e tokës në përdorim. Po ashtu, verifikimi i titujve të tokës bujqësore u shty deri në fund të 2019-ës.

**AMTP**

Në relacionin e projektligjit mësohen edhe dhënat në të gjithë procesin. "Lidhur me procesin e pajisjes me AMTP për periudhën 1991 deri 15 gusht 2008 janë dhënë 43 1898 AMTP. Janë në proces të plotësimit 7310 AMTP, të cilëve i korrespondon një sipërfaqe prej 3471 ha, ndërkohë që janë plotësuar 4123 AMTP, të cilëve i korrespondon një sipërfaqe prej 1407 ha. Lidhur me procesin e regjistrimit të AMTP-ve janë regjistruar afërsisht 250.000 AMTP. Në lidhje me procesin e verifikimit të AMTP-ve nga 23520 kërkesa për verifikim gjithsej, janë 4432 vendime të mara, si dhe 12.069 përgjigje administrative për kërkesat e paraqitura. Lidhur me procesin e legalizimeve, nga 227.000 objekte të legalizueshme, deri në nëntor 2018 janë legalizuar 164.866 objekte. Në lidhje me kalimin në pronësi të oborreve në përdorim janë paraqitur rreth 2500 kërkesa nga të cilat janë dhënë 1429 vendime. Janë për t'u shqyrtuar dhe për të marrë vendim 848 dosje", - thuhet në relacionin që shoqëron ndryshimet ligjore.

**AFATET**

Projektligji i ri përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit përcjellin pranë ASHK kërkesat për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të administruara sipas ligjeve nr.171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të të përfituesve" dhe nr.9948, 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit duhet të evidentojnë edhe përdorues të tjerë faktikë, të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë si më sipër, si dhe ata të cilët kërkesa u është refuzuar në bazë të ligjeve sa më sipër, por plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.


Foto ilustruese

### KUSHTET PËR LIGJËSIMIN E AKTIT TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI

**1.** Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), i fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet i vlefshëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
**a)** Subjekti ka qenë legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe nëse nuk ka qenë legjitimuar, ka përfituar tokën për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit gjatë krijimit të kooperativës apo ndërmarrjes bujqësore.
b) Subjekti ka përfituar tokë vetëm në territorin e një kooperative apo ndërmarrjeje bujqësore.
**c)** Toka e ndarë me AMTP nuk ka qenë e llojit (zërit kadastral) "truall", "rëra bregdetare" ose "plazhe".
**2.** Llojet e mangësive në elementet e formës, që janë shkak për mosligjësimin e AMTP-ve, si dhe mënyra e plotësimit të AMTP-ve me mangësi jothelbësore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
**3.** Mosplotësimi i kritereve të akteve ligjore e nënligjore për tokën bujqësore, që nuk janë listuar në pikën 1 të këtij neni, përfshirë edhe "normën për frymë", nuk përbën shkak për mosligjësimin e AMTP-ve.
**4.** Kontrolli i AMTP-ve në raport me kushtet për ligjësimin sipas këtij neni realizohet gjatë procedurave të regjistrimit dhe/ose përmirësim/përditësimit të regjistrit të pasurive të paluajtshme.

### ÇFARË PËRFITOJNË PERSONAT QË KANË MARRË TOKË ME 7501

**1.** Ligjësimin e akteve të marrjes në pronësi të tokës bujqësore.
**2.** Kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, tek subjektet që e kanë atë në përdorim dhe janë përfshirë në procesin administrativ nëpërmjet kërkesës apo që kanë një titull përdorimi.
**3.** Rregullimin ligjor, me qëllim regjistrimin e AMTP-ve për rastet kur situata faktike e pronave është e ndryshme nga ajo e përcaktuar në titull.
**4.** Ligjësimin dhe regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimet pa leje.
**5.** Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të drejtat mbi ndërtimin që legalizohet; rregullime të posaçme për një sërë rastesh të veçanta që paraqesin nevojë për zgjidhje, si për objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim.
**6.** Kushtet e procedurat për përfundimin e procesit të përditësimit, inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronës shtetërore.
**7.** Procesin e përditësimit të listës së pronave shtetërore, si një procedurë tepër e rëndësishme, në funksion të pasqyrimit në regjistrin publik të gjendjes reale të pasurive dhe të përputhjes së marrëdhënieve juridike me këtë gjendje.
**8.** Jep zgjidhje për detyrimin e papërmbushur nga institucionet shtetërore dhe vendore, për të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pronat e tyre duke u vendosur njësive të vetëqeverisjes vendore detyrimin që të krijojnë një strukturë të posaçme, e cila do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie.
**9.** Përditësimin e të dhënave në lidhje me pasuritë e sindikatave me qëllim përditësimin dhe inventarizimin e gjendjes dokumentare të pasurive të këtyre subjekteve, në funksion të sigurisë së informacionit për to, në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
**10.** Rregullimin e pronësisë në zonat e stimuluara, ku ASHK-ja do të kryejë evidentimin në terren të njësive ndërtimore dhe truallit, si dhe harton planin e rilevimit, ku pasqyrohet gjendja ndërtimore faktike e zonës, sipas kufijve të vendosur në dokumentacionin e miratuar nga autoriteti i planifikimit të territorit.
**11.** Harmonizimin e proceseve kalimtare me procesin e trajtimit të pronës sipas ligjit nr.133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".
**12.** Rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë mbi truallin e ndërtesave të shitura nga ndërmarrjet shtetërore apo të privatizuara, përpara dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, të shfuqizuar.
**13.** Përcaktimin e të ardhurave që përfitohen nga proceset kalimtare dhe destinacionin e tyre.



# Praktikë pune në administratë, kushtet dhe dokumentet

Qeveria hapi aplikimet për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, e cila do të jetë tre muaj. Afati për aplikim është deri më datë 28 shkurt 2019. Aplikimi është i hapur për të rinjtë profesionistë nga mosha 21 deri 26 vjeç, të cilët zotërojnë minimalisht një diplomë bachelor ose të barasvlefshme. Vendimi është marrë në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", i ndryshuar. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall hapjen e thirrjes së katërt të Programin Kombëtar të Praktikave të Punës. Pjesëmarrësit do të përfshihen në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre në praktikë. Aplikantët duhet të dorëzojnë CV-në e aplikantit, diplomën e përfundimit të studimeve të shkollës së lartë, listën e notave dhe një letër motivimi. Ndërkohë që aplikimet do të bëhet 'online' në linkun http://praktika.arsimi. gov.al/ .

Ndërtimet e paligjshme, miratohet fondi për pagesën e tokës së zënë pa leje

# VKM-ja/ ALUIZNI, jep 552 mln lekë për kompensimin e 753 pronarëve

## *Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë*

Qeveria miraton kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. ALUIZNI publikon listën me 753 pronarë që përfitojnë fondin e miratuar dje. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë.

**VENDIMI**

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. "Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Korçë, Kukës, Kavajë dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme", përcakton më tej vendimi. Ndërkohë, ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

**APLIKIMI**

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

### APLIKIMI PËR TË MARRË PARATË DHE DOKUMENTET

■ ATP-ja, në zbatim të VKM nr. 383/2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" i ndryshuar, procedon si më poshtë:

**1.** Njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.

**2.** Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.

**3.** Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë paraqet pranë ATP-së gjithë dokumentacionin e lartpërmendur.

**4.** Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës.

**5.** Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura.

**6.** Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës: a) nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi; b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen; c) njofton kërkuesin që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mos përfshirjes.

| Numri I Pronarëve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | REFIK | IDRIZ | SHEHI | 1 | 99/2 | 338.7 | 221 | 74,852.70 |
| 2 | SUZANA | THOMA | PERIHANA | | | | | |
| 3 | SADETE | SABRI | PERIHANA | | | | | |
| 4 | BLERTA | HALIT | PERIHANA | | | | | |
| 5 | ALESIO | IBRAHIM | PERIHANA | | | | | |
| 6 | VALBONA | AGIM | PERIHANA | | | | | |
| 7 | FITNETE | MUSA | PERIHANA | | | | | |
| 8 | DELINA | HYSNI | PERIHANA | | | | | |
| 9 | GANI | DEMIR | LULJA | | | | | |
| 10 | RUDINA | DEMIR | LULJA | | | | | |
| 11 | SUZI | HAMIT | BEGEJA | | | | | |
| 12 | SAIMIR | SAMI | PERIHANA | 2 | 11/226 | 73.3 | 13,666 | 1,001,717.80 |
| 13 | DANE | | STRINGA | | | | | |
| 14 | LUAN | | STRINGA | | | | | |
| 15 | ARFA | | GARUNJA | | | | | |
| 16 | HAXHIRE | | STRINGA | | | | | |
| 17 | NEXHMIJE | | BORIÇI | | | | | |
| 18 | ENGJELLUSHE | | STRINGA | | | | | |
| 19 | XHAFERR | | MUSAI | | | | | |
| 20 | ASIME | | SERJANI | | | | | |
| 21 | PERPARIM | | SERJANI | | | | | |
| 22 | JASIN | | SERJANI | | | | | |
| 23 | TELHA | | SERJANI | | | | | |
| 24 | ADRIATIK | | SERJANI | | | | | |
| 25 | DURIM | | URUPI | | | | | |
| 26 | ALIJE | | GURRA | 3 | 17/135 | 128.9 | 12,764 | 1,645,279.60 |
| 27 | NASHIFER | | SHQERRA | | | | | |
| 28 | PRANVERA | | ÇAKA | | | | | |
| 29 | BEQIR | | URUPI | | | | | |
| 30 | EDUART | | DUSHKU | | | | | |
| 31 | JONUZ | | PLAKU | | | | | |
| 32 | AFERDITA | | KAPIDANI | | | | | |
| 33 | TOMORR | | KAPIDANI | | | | | |
| 34 | HYQMET | | PEQINI | | | | | |
| 35 | REFIK | | PEQINI | | | | | |
| 36 | ENGJELLUSHE | | PEQINI | | | | | |
| 37 | BURBUQE | | PEQINI | 4 | 3/383 | 21.60 | 12,764 | 275,702.40 |
| 38 | XHEVDET | | KOKUNJA | | | | | |
| 39 | FATUSH | | KOKUNJA | | | | | |
| 40 | MITHAT | | KOKUNJA | | | | | |
| 41 | BUKUROSH | | KOKUNJA | | | | | |
| 42 | AGIM | | KOKUNJA | | | | | |
| 43 | SEJMIR | | KOKUNJA | | | | | |
| 44 | BURBUQE | | KOKUNJA | | | | | |
| 45 | NEVIT | | KASA | | | | | |
| 46 | NIKO | | KASA | | | | | |
| 47 | ALMA | | ÇARÇANI | | | | | |
| 48 | MYZEJEN | | KOKUNJA | | | | | |
| 49 | REZARTA | | KOKUNJA | | | | | |
| 50 | KAMER | | KOKUNJA | 5 | 13/171 | 118.7 | 12,764 | 1,515,086.80 |
| 51 | MILI(XHEMILE) | MAHMUT | SHINGJERGJI | | | | | |
| 52 | MEREME | IBRAHIM | SHINGJERGJI | | | | | |

| Numri I Pronarëve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 53 | BARDHYL | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 54 | ALEMSHAH | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 55 | MAHMUT | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 56 | LIRI | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 57 | EDUART | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 58 | DASHURI | ALI | SHINGJERGJI | | | | | |
| 59 | HILMI | HAMIT | SHINGJERGJI | | | | | |
| 60 | SHEMSI | | MAVJANI | | | | | |
| 61 | TEUTA | SHEMSI | MAVJANI | | | | | |
| 62 | SOKOL | SHEMSI | MAVJANI | | | | | |
| 63 | LIRI | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 64 | NEVJANA | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 65 | ABDULLAH | | BALLHYSA | | | | | |
| 66 | VJOLLCA | | BALLHYSA | | | | | |
| 67 | RUZHDIJE | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 68 | HASAN | | MATRAXHIU | | | | | |
| 69 | HEDIJE | | MATRAXHIU | | | | | |
| 70 | AIDA | | MATRAXHIU | | | | | |
| 71 | SAIMIR | | MATRAXHIU | | | | | |
| 72 | VANTHI | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 73 | ARMAND | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 74 | LINDITA | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 75 | MANJOLA | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 76 | LORETA | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 77 | KRISTO | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 78 | ALBERT | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 79 | MENCURI | | SHINGJERGJI | | | | | |
| 80 | FLUTURAKE | | SHINGJERGJI | 6 | 23/275 | 45.1 | 12,764 | 575,656.40 |
| 81 | VALENTINA | ASHKI | HASEKIU | | | | | |
| 82 | QAZIM | ASHKI | HASEKIU | | | | | |
| 83 | VERONIKA | ASHKI | HASEKIU | | | | | |
| 84 | ARTA | ASHKI | HASEKIU(KOPILI) | | | | | |
| 85 | ELEONORA | ASHKI | HASEKIU(KARDHASHI) | | | | | |
| 86 | MERITA | ASHKI | HASEKIU | | | | | |
| 87 | LUAN | HAKI | HASEKIU | | | | | |
| 88 | FATMIR | HAKI | HASEKIU | | | | | |
| 89 | SHAHU | HAKI | HASEKIU | | | | | |
| 90 | FERDINAND | HAKI | HASEKIU | | | | | |
| 91 | NIMETE | | HASEKIU | | | | | |
| 92 | ELIDA | MEHMET | HASEKIU | | | | | |
| 93 | MIMOZA | MEHMET | HASEKIU | | | | | |
| 94 | HYSEN | MEHMET | HASEKIU | 7 | 30/254 | 57.4 | 14,192 | 814,620.80 |
| 95 | ILIR | NAMIK | DAIU | | | | | |
| 96 | SUZANA | QEMAL | MATRAXHIU(ZALOSHNJA) | | | | | |
| 97 | BARDHYL | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| 98 | SHKELQIM | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| 99 | ENGJELL | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| 100 | ZEGJINE | BEQIR | DAIU | | | | | |
| 101 | BLEGINA | NAMIK | HADO(DAIU) | | | | | |
| 102 | FATMIR | ISMAIL | DAIU | | | | | |
| 103 | BESNIK | ISMAIL | DAIU | | | | | |
| 104 | ARDIANA | ISMAIL | LUFTA(DAIU) | 8 | 9/23 | 286.6 | 12,764 | 3,658,162.40 |
| 105 | VJOLLCA | ALI | KRYEMADHI | | | | | |
| 106 | SUAZANA | ALI | MURATAJ | | | | | |
| 107 | LEJLA | ALI | MARKU | | | | | |
| 108 | SAIBE | ALI | GOGA | | | | | |
| 109 | | | | 9 | 9/31/1 | 1486.70 | 12,764 | 18,976,238.80 |
| 110 | DIANA | MUSTAFA | AGARA(KAPERCELLI) | | | | | |
| 111 | SHEFIKAT | SULEJMAN | JAUPAJ(KAPERCELLI) | | | | | |
| 112 | SULEJMAN | MUSTAFA | KAPERCELLI | | | | | |
| 113 | EMINE | FEJZULLA | KAPERCELLI | 10 | 89/9 | 137 | 12,764 | 1,748,668.00 |
| 114 | FATMIRA | MYRTEZA | GREMI | 11 | 3.5.2015 | 492.7 | 12,764 | 6,288,822.80 |
| 115 | SAIDE | | PAJOVA | | | | | |
| 116 | ZYBA | | MUSAJ | | | | | |
| 117 | FATMIR | | BESNIKU(KOPILI) | | | | | |
| 118 | ENGJELLUSHE | IBRAHIM | SHENGJERGJI | | | | | |
| 119 | ZYHRA | | GRECA | | | | | |
| 120 | MAKBULE | | ZENELHOXHA | | | | | |
| 121 | HYSEN | | VELENICA | | | | | |
| 122 | HIQMETE | | LABINOTI | | | | | |
| 123 | EDISON | | VELENICA | | | | | |
| 124 | SHEFQET | | TUXHARI | | | | | |
| 125 | ILIRJANA | | STAFA | | | | | |
| 126 | MARIA | | JORGO | | | | | |
| 127 | ARTUR | | MEZINI | | | | | |
| 128 | KRENAR | | MEZINI | 12 | 1328/16/2 | 308.9 | 12,764 | 3,931,056.72 |
| 129 | FLUTUR | RAMAZAN | HOTI | | | | | |
| 130 | RAZIJE | SELMAN | KOPLIKU | | | | | |
| 131 | SKENDER | ASIM | MUÇA | 13 | 1328/22/1 | 110.74 | 12,764 | 1,414,506.48 |
| 132 | SAIDE | | PAJOVA | | | | | |
| 133 | ZYBA | | MUSAJ | | | | | |
| 134 | FATMIR | | BESNIKU(KOPILI) | | | | | |
| 135 | ENGJELLUSHE | IBRAHIM | SHENGJERGJI | | | | | |
| 136 | ZYHRA | | GRECA | | | | | |
| 137 | MAKBULE | | ZENELHOXHA | | | | | |
| 138 | HYSEN | | VELENICA | | | | | |
| 139 | HIQMETE | | LABINOTI | | | | | |
| 140 | EDISON | | VELENICA | | | | | |
| 141 | SHEFQET | | TUXHARI | | | | | |
| 142 | ILIRJANA | | STAFA | | | | | |
| 143 | MARIA | | JORGO | | | | | |
| 144 | ARTUR | | MEZINI | | | | | |
| 145 | KRENAR | | MEZINI | 14 | 1328/16/3 | 359.8 | 12,764 | 4,592,487.20 |
| 146 | MANDI | BUJAR | TOLA | | | | | |
| 147 | INDRIT | BUJAR | TOLA | | | | | |
| 148 | FATIME | RAMAZAN | TOLA | | | | | |
| 149 | BEDRIJE | OSMEN | TOLA | | | | | |
| 150 | ALBANA | ENVER | VALERA | | | | | |
| 151 | DRITAN | ENVER | TOLA | | | | | |
| 152 | SHEFQET | QAMIL | TOLA | | | | | |
| 153 | NDRIÇIM | QAMIL | TOLA | | | | | |
| 154 | LIRI | QAMIL | TOLA(SKUQI) | 15 | 83/11 | 472.7 | 12,764 | 6,033,542.80 |
| 155 | VANGJEL | ANDON | MILLO | 16 | 3.5.2029 | 303.1 | 12,764 | 3,868,768.40 |
| 156 | ALI | HYSEN | KOPILI | | | | | |
| 157 | BIHANE | IDRIZ | ZYMA | | | | | |
| 158 | LUMNI(LUMTURI) | HYSEN | VERO(KOPILI) | | | | | |
| 159 | SUZANA | HYSEN | XHEPA(KOPILI)) | 17 | 1324/1 | 1159.3 | 12,764 | 14,797,305.20 |
| 160 | PAQIZE | VELI | SULO | 18 | 383/117 | 751.5 | 12,764 | 9,592,146.00 |
| 161 | PAQIZE | VELI | SULO | 19 | 383/87 | 335.4 | 12,764.00 | 4,281,045.60 |
| 162 | ILIR | ISMAIL | BASHA | 20 | 391/22 | 313.8 | 12,764 | 4,005,343.20 |
| 163 | QENDRIME | FAIK | TAFA | 21 | 391/23 | 250 | 12,764 | 3,191,000.00 |
| 164 | ILIR | ISMAIL | BASHA | 22 | 391/27 | 141.5 | 12,764 | 1,806,106.00 |
| 165 | VASLIE | KOSTANDIN | KAÇORRI | 23 | 391/28 | 121.2 | 12,764 | 1,546,996.80 |
| 166 | IKBAL | | KRASNIQI | 24 | 391/17 | 218.1 | 12,764 | 2,783,828.40 |
| 167 | HASAN | OSMAN | VELIU | 25 | 442/7/2 | 369.6 | 12,764 | 4,717,574.40 |
| 168 | ODIN | | LIBOHOVA | | | | | |
| 169 | MEHTAP | | BIÇAKU(VERLACI) | | | | | |
| 170 | FRANKLIN | | DINO | | | | | |
| 171 | LEILA | | DINO | | | | | |
| 172 | NEVIN | | DINO | | | | | |
| 173 | NERSIN | | DINO | | | | | |
| 174 | NEMIN | | DINO | 26 | 1222/6 | 166.1 | 12,764.00 | 2,120,100.40 |
| 175 | ERVAL | | LIBOHOVA | | | | | |
| 176 | SILVEN | | LIBOHOVA | | | | | |
| 177 | SERES | | TURKU(LIBOHOVA) | | | | | |

## KRIMET SEKSUALE
### GRATE

"Viktimat nuk përfitojnë ndihmë financiare nga shteti për të filluar një jetë të re"

# Vrasjet e grave, avokatja: Nënshtrimi ekonomik dhe mentaliteti, faktorët kryesorë

## *Arjola Alika: Në 2018-ën, 110 krime seksuale të raportuara*






Voltiza Duro

Brenda këtij viti, plot 6 gra e vajza kanë humbur jetën pas agresionit nga bashkëshortët, bashkëjetuesit, apo dhe vetë baballarët. Përqindja më e lartë e grave që përjetojnë dhunë në familje, është në qarkun e Tiranës me 35,8 % gra të dhunuara, ndjekur nga qarku i Durrësit me 13,9 %, ndërsa qarku i Kukësit dhe ai i Dibrës kanë përqindjen më të ulët, përkatësisht, 0,9 dhe 1,5 % gra të dhunuara. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Arjola Alikaj, avokate e njëkohësisht anëtare e Komitetit të Grave për Këshillin Rajonal Europian, PERC, dhe përfaqësuese e BSPSH-së tregon se rastet e dhunës në familje pasqyrojnë numrin e raportimeve të bëra në polici, dhe përfshijnë edhe rastet në të cilat ky fenomen ka shkaktuar vdekjen e personit. Ajo thekson se në vitin 2017, nga 50 vrasje të ndodhura, 26,0 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve në familje. Avokatja bën me dije se në vitin 2018, janë evidentuar plot 110 raste si krim me natyrë seksuale e madje shton se dhunë me bazë gjinore është ushtruar edhe në vendet e punës. Alikaj shton se gratë e dhunuara si fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht nuk përfitojnë ndonjë ndihmë financiare nga shteti për të filluar një jetë të re larg dhunuesit. Ajo shton se duhet një strategji e të gjithë aktorëve për të parandaluar krimin në familje, e për të parandaluar humbjen e viktimave të pafajshme.

**Në më pak se dy muaj, 6 gra e vajza kanë humbur jetën pasi janë vrarë nga bashkëshortët, të dashurit apo baballarët e tyre.**

**DHUNA**
Dhuna me baze gjinore ekziston dhe në vendet e punës, ku pjesa më e madhe e punonjëseve kanë frikë t'i denoncojnë për shkak se përballen me largime nga puna. Punëdhënësit përdorin dhunë psikologjike, madje ka dhe raste të dhunës fizike, të cilat vetëm në ndonjë rast sporadik janë bërë publike. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë ka mbështetur i pari në Shqipëri, Konventën e Re të ILO-s

**Cili është opinioni juaj si avokate mbi rritjen e numrit të vrasjeve të grave dhe vajzave në Shqipëri?**

Krimi në familje ka marrë përmasa të frikshme në Shqipëri sidomos në fillim të vitit 2019-të. Më konkretisht, nëse do t'i referohemi kalendarit të vrasjeve nga data 1 janar-12 shkurt 2019, numërohen këto krime. Vrasja e parë u shënua në fillimet e vitit të ri, konkretisht në datën 2 janar 2019, vrasje e dyfishtë, e cila ndodhi në Ballsh. Autori, Gazmend Musta vrau bashkëshorten e tij dhe motrën e saj 18-vjeçare. Një ditë më pas u bë publike një tjetër vrasje makabre që ndodhi në Alepu, Korfuz të Greqisë, ku një shqiptar vrau vajzën e tij 28 vjeçare dhe më pas e fshehu trupin e saj në kopshtin e shtëpisë.

Në 14 janar 2019, autori i krimit, i identifikuar si Majlind Lila, 52 vjeç, qëlloi disa herë me një pistoletë mbi vjehrrin dhe vjehrrën, te ndjerët Bujar dhe Xhevahire Mata, duke i lënë ata të vdekur në vend. Në 6 Shkurt 2019, një tjetër viktimë femër u shënua në qytetin e Vlorës. Bëhet fjalë për një tjetër krim në familje, burri vret me thikë bashkëshorten e tij dhe më pas pret damarët. Më 12 shkurt viktima e fundit u shënua në "Allias", ku bashkëshorti, Alket Arapaj, vrau bashkëshorten e tij, Ervilma Seferaj, për motive të dobëta me armën e shërbimit.

**Sipas statistikave, sa është numri i denoncimeve për dhunë në familje dhe nga cilat qytete vijnë më së shumti raportimet?**

Më konkretisht në vitin 2017, numërohen në terma absolutë 3243 gra të dhunuara. Përqindja më e lartë e grave që përjetojnë dhunë në familje, është në qarkun e Tiranës me 35,8% gra të dhunuara, ndjekur nga qarku i Durrësit me 13,9%, ndërsa qarku i Kukësit dhe ai i Dibrës kanë përqindjen më të ulët, përkatësisht, 0,9 dhe 1,5 % gra të dhunuara. Numri i grave të dhunuara në raport me numrin e popullsisë është më i lartë në qarkun e Durrësit, Vlorës dhe Tiranës me normë përkatësisht 32, 26,6 dhe 26, 3 të dhunuara për 10 mijë banore gra. Rastet e dhunës në familje pasqyrojnë numrin e raportimeve të bëra në polici, dhe përfshijnë edhe rastet në të cilat ky fenomen ka shkaktuar vdekjen e personit. Në vitin 2017, nga 50 vrasje të ndodhura, 26, 0 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve në familje.

**Sa është numri i denoncimeve nga gratë dhe vajzat që raportojnë raste ngacmimi apo abuzimi seksual?**

Në tremujorin e parë 2018, janë evidentuar 13 krime me natyrë seksuale. Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar 31 krime me natyrë seksuale, 9 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Nga këto, 8 prej tyre i përkasin veprës penale "Vepra të turpshme". Në këtë periudhë janë evidentuar 33 autorë për veprën krime me natyrë seksuale, duke shënuar një rritje me 13 autorë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në tremujorin e tretë 2018, janë evidentuar 38 krime me natyrë seksuale, 3 më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Në këtë periudhë janë evidentuar 37 autorë për veprën krime me natyrë seksuale. Në tremujorin e katërt 2018, 31 janar 2019 janë evidentuar 28 krime me natyrë seksuale, 7 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

**A ka pasur raste dhune me bazë gjinore në vendet e punës dhe cilat janë format e saj?**

Dhuna me baze gjinore ekziston dhe në vendet e punës, ku pjesa më e madhe e punonjëseve kanë frikë t'i denoncojnë për shkak se përballen me largime nga puna. Punëdhënësit përdorin dhunë psikologjike, madje ka dhe raste të dhunës fizike, të cilat vetëm në ndonjë rast sporadik janë bërë publike. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë ka mbështetur e para në Shqipëri, Konventën e Re të ILO-s "Eliminimin e Dhunës me Bazë Gjinore në Vendin e Punës, Konventë kjo e cila do aprovohet në Qershor në Konferencën Vjetore të ILO-s. Për këtë Konvente ne morëm dhe konfirmimin në Këshillin Kombëtar të Punës nga ish-ministri Arben Ahmetaj që MEF do ta mbështetëse këtë Konventë në qershor në Gjenevë. Miratimi i kësaj Konvente do të jetë e detyrueshme për të gjitha

**DENONCIMET**
Në tremujorin e parë 2018 janë evidentuar 13 krime me natyrë seksuale. Në tremujorin e dytë 2018 janë evidentuar 31 krime me natyrë seksuale, 9 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Nga këto, 8 prej tyre i përkasin veprës penale "Vepra të turpshme". Në këtë periudhë janë evidentuar 33 autorë për veprën krime me natyrë seksuale, duke shënuar një rritje me 13 autorë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Udhëzimi/ Provimi në 24 maj të 2019-ës, si do të jetë procedura për PAK

# Vendimi i Ministrisë së Arsimit: Testim për nxënësit e klasave të pesta

## *Zbardhen 3 lëndët ku do të vlerësohen arritjet e arsimit fillor*

Voltiza Duro




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI
UDHËZIM
Nr. 2, datë 06.02.2019
"PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR 2019"

Nxënësit e klasave të pesta në mbarë vendin do të testohen për dijet e përvetësuara në arsimin fillor. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot vendimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në të cilin theksohet se testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre. Gjithashtu, në udhëzimin e firmosur nga ministrja Besa Shahini, publikohet edhe data e zhvillimit të provimit për këta nxënës. "Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50 të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar udhëzoj: Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 24 maj 2019, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta",-theksohet në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit. Në këtë të fundit bëhet me dije se ky testim do të fillojë në orën 10.00 dhe do të zgjasë 1 orë e 30 minuta. Ndërkohë, nxënësit me aftësi te kufizuara do te zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.

**TESTIMI**

Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren "Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2019". Ndërkaq Instituti i nxënësve që nuk shikojnë do të tërheqë testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail. "Institucioni Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, do të monitorojë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe do të raportojë për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij"-thuhet në udhëzimin e MASR.

**ARKIVIMI**

Në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit, dhe Rinisë bëhet me dije se arkivimi i testeve që do të zhvillojnë nxënësit e klasave të pesta, do të bëhet pranë institucioneve arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar. "Sektori i statistikës i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit (QVT), dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA dhe MASR",-nënvizohet në udhëzimin e ministrisë. Në këtë të fundit thuhet më tej se për zbatimin e këtij udhëzimi, do të ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Institucioni Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin parauniversitar dhe Institucionet arsimore Vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

**24**

**MAJ 2019**
**TESTIMI**

"Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50 të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar udhëzoj: Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 24 maj 2019, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta",- theksohet në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit.



**PROBLEMATIKA**

Gratë e dhunuara si fizikisht dhe emocionalisht dhe psikologjikisht nuk përfitojnë ndonjë ndihmë financiare nga shteti për të filluar një jetë apo të kenë një mundësi të re, për t'u dhënë mundësi atyre që të mos jetojnë në një banesë me bashkëjetuesin, apo shërbim ligjor falas.

shtetet, dhe besojmë që do sjellë një fryme të re në çështje të denoncimit, apo heshtjes nga punonjëset. Duke qenë se BSPSH ka realizuar fushata sensibilizuese për shumë çështje të barazisë gjinore, do të prezantojmë dhe strategjinë tonë për parandalimin e dhunës ndaj femrave në "UN Women New York" në konferencën e përvitshme. Për këtë arsye po bashkëpunojmë me PERC, ku BSPSH është anëtare dhe përcjell zërin e të gjithë punonjëseve shqiptare, ILO- Shqipëri, NGO të ndryshme, Organizata të Punëdhënësve për të adresuar çështje të ndryshme të Barazisë Gjinore në Konferencën e "UN Women New York".

**Cilët janë faktorët që ndikojnë në vrasje apo përdhunim të vajzave e grave?**

Faktori ekonomik është një nga faktorët kryesore që sjell dhe probleme të rënda në familje. Të rralla janë femrat të cilat kanë pavarësi financiare, e cila ndikon në marrje të vendimeve të drejta në momente të duhura. Shumica dërmuese e femrave shqiptare janë të nënshtruara për shkak të mentalitetit dhe mundësive ekonomike nga bashkëjetuesit dhe madje janë dhe të dhunuara fizikisht dhe psikologjikisht nga ata në rast se i denoncojnë. Këto femra duhet të gjejnë guximin për t'i denoncuar të gjitha aktet e dhunës dhe kjo mund të parandalojë dhe aktet ekstreme, siç janë vrasjet.

**Cila është zgjidhja që iu ofrohet viktimave?**

Gratë e dhunuara si fizikisht dhe emocionalisht dhe psikologjikisht nuk përfitojnë ndonjë ndihmë financiare nga shteti për të filluar një jetë apo të kenë një mundësi të re, për t'u dhënë mundësi atyre që të mos jetojnë në një banesë me bashkëjetuesin, apo shërbim ligjor falas. Mund të jenë shumë pak organizata të cilat mund të ofrojnë ndihmë ligjore falas, ose të kenë mundësi që ato dhe fëmijët e tyre të trajtohen në një mënyrë të veçantë dhe me psikologë për të kaluar këto trauma. Pavarësia financiare është një nga pengesat kryesore të femrave shqiptare në përballimin e jetesës, të cilat i detyrojnë ato t'i rikthehen përsëri jetës me bashkëjetuesin, që në shumë raste ka qenë me fatale deri në humbjen e jetës së tyre.

**A duhet të ketë ndryshime në aktet nënligjore për dhunën në familje në mënyrë që të minimizohen vrasjet?**

Edhe pse është e parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 47/2018 për asistencë për një strehim të përkohshëm dhe të sigurt të viktimave, përsëri ka problem në zbatim të ligjit, kjo pasi shumica e femrave për shkak të mentalitetit dhe familjeve të tyre, e quajnë martesën si një tabu, nuk kanë informacionin e nevojshëm se ku duhet të drejtohen, rrugën dhe procedurën që duhet të ndjekin. Neni 7/1 i ligjit 9669 i dt. 18.12.2006 i ndryshuar në vitin 2018, garancia për mbrojtjen thekson: 1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktima, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës. 2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Edhe pse ndryshimet janë bërë në Kodin Penal që të mospërfitojnë nga gjykimi i shkurtuar, personat që kryejnë vepër penale të vrasjes në familje, përsëri nuk janë të mjaftueshme, pasi nga statistikat, këto vrasje brenda në familje po shtohen, sikur rasti i Fadil Kasemit, i cili vrau të ndjerën Fildez Hafizin dhe u dënua me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Duhet një strategji e të gjithë aktorëve për të parandaluar krimin në familje, për të parandaluar humbjen e jetëve të pafajshme.

bashkëpunimi german

Implemented by giz

## Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial with regard to socio-economic development in Al-bania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agri-cultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment op-portunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

Output 1) Policy Advice for Rural Development
Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

The programme's target groups focus on young people and returning migrants. In total 5 of the programme's 10 Mio. EUR are coming from the fund for returning migrants (Perspektive Heimat)

**"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:**
**Advisor - Communication and Outreach**

**A. Responsibilities**
The candidate is responsible for:
■ Development and implementation of a communication and outreach strategy for the pro-gramme for its activities in agriculture, diversification and rural tourism
■ Monitoring and reporting the programme's results in the context of the returning migrants (reporting on indicators and storytelling)
■ Identifying digitalization needs for internal project management and for the service delivery of the programme; designing and coordination measures regarding digitalization
ª% Supporting the development stakeholder networks in the programme's fields of intervention in close cooperation with relevant advisors.
■ nnovation and knowledge management;
■ Maintaining of a good flow of communication and information between all involved institu-tions and counterparts and GIZ including regional and global projects

**B. Tasks**

**1. Communication & Outreach**

The candidate
■ Develops a communication strategy of the programme in close cooperation with the pro-gramme manager and the team (this involves use of social media, development of PR ma-terials, events etc.)
■ Coordinates the implementation of the communication strategy
■ dentifies digitalization needs of the programme;
■ ainstreams digitalization requirements of GIZ HQ and GIZ Office Albania;
■ Advises the team on digital tools and innovation for internal use as well as service delivery in the programme's fields of intervention
■ Conducts knowledge management in the field of digitalization vis-à-vis GIZ Albania and GIZ HQ if needed

**2. Outreach & Networking**

The candidate
■ Supports the technical advisors in agriculture and rural tourism to facilitate the establish-ment of networks of their respective target groups and key stakeholders (farmers, tourism service providers, returnees etc.)
■ Facilitates the exchange of knowledge, lessons learnt, good practices and innovation be-tween key stakeholders and networks relevant for the programme
■Participates in relevant GIZ groups (Fachverbund, Communities of Practice, IDA groups, GIZ Albania groups)

**3. Monitoring Perspektive Heimat**
■dentifies monitoring and reporting needs regarding the returnee funds
■Coordinates monitoring of respective indicators and prepares storytelling and PR measures according to needs
■Liaison to monitoring staff of other relevant projects (esp. ProSEED and PME) and respec-tive focal persons in HQ
■Mainstreams updates and information with regard to migration issues from HQ and from Albania

**C. Required qualifications, competences and experience:**

**Qualifications**
■ university degree in social sciences or communication
■ 3-5 years' professional experience in communication management or related fields
■interest in rural development and employment issues
■professional knowledge on digitalization issues and tools
■professional experience in communication and outreach activities
■basic knowledge of issues related to returning migrants and the BMZ programme "Perspe-kive Heimat"
■professional experience with working with young people, private sector actors and returning migrants is desired but not a precondition
**■ knowledge of German language (reading, speaking and writing) is essential for this position and a precondition for the candidate's selection**
■confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
■strong organisational competence
■strong desire and ability to work in a team
■willingness to travel within Albania regularly
■very good knowledge of English as working language of the programme
■willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

**Contract conditions:**
• Full time Employment
• Programme office in Tirana
• Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **24th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: **giz-albanien-hr@giz.de** including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

Please note that the interview will be partly conducted in German language!
***GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!***

**SHPF in Albania is looking for a dynamic Executive Director with 5 years of relevant work experience. Under the overall supervision of Board of Directors and the President of the Association, the Executive Director is responsible for the day-to-day management of the SHPF activities, services, including all substantive and administrative matters. The position will be based in Tirana and be offered a full time assignment.**

**Duties & Responsibilities**

■ Manage and coordinate day-to-day SHPF activities, from substantive, administrative and financial points of view
■ Ensure a good relationship with the SHPF Board members by supporting their operations. Responsible for implementing Board's strategic agenda and policies. Organize and facilitate regular Board of Directors' meetings
■ Actively maintain existing members and seek out new members
■ Ensure timely preparation and compilation of the SHPF Annual/Quarterly Work Plans and their submission to the Board as appropriate
■ Prepare monthly reports for the Board on the SHPF key activities, issues and required action points. Prepare annual/semi-annual progress and financial reports and submit them to SHPF Board as appropriate. Ensures Committee's output is delivered according to organization's policies.
■ Provide direction and leadership in advocating the SHPF objectives, in ensuring that all interested parties are well informed about the SHPF activities and goals
■ Represent SHPF as required in Albania and build professional relationships with national and regional health care authorities and relevant national and international partners to ensure the full participation of a broad spectrum of national leadership in the identification, planning and execution of SHPF activities
■ Serve as media contact in order to enhance SHPF image
■ Advocate the interests of the members in improving the pharmaceutical business climate in Albania
■ Maintain relationships with the Government of Albania and EFPIA

**Required Qualifications/Competencies**

■ 5 years of relevant working experience.
■ A Minimum of University Degree
■ Strong managerial skills, ability to work in a dynamic and multipurpose environment.
■ Highly developed leadership skills including the ability to inspire, encourage and build trust and confidence. Proven experience working in service to a broad range of clients and stakeholders
■ In depth knowledge of the pharmaceutical market and dinamics. Solid understanding of the issues facing countries in economic transition
■ Excellent communication skills both written and oral in both English and Albanian (conversant). Proven ability to draft, edit and produce written proposals and results-focussed reports
■ Proven experience working with Government, civil society, international organizations and donors
■ Experience in the usage of computers and office software packages (MS Word, Excel, etc.)
■ Familiarity with social media
■ Strong and documented management skills and experience. He/she should be able to set clear standards for accountability, probity, value for money and risk management; to ensure sound and transparent financial management; and deliver continuing improvement in the SHPF effectiveness and in its systems to measure and report on this
■ The ability to think beyond traditional modes and to be innovative in seeking solutions to complex operational and logistical challenges
■ Ability to fulfill SHPF responsibility of accountability and transparency to members of the Board and other stakeholders
■ Strong advocacy skills to be utilized in extensive public speaking, media interviews and interaction, giving testimony to intergovernmental bodies, and advocating for SHPF

The application deadline for this position is 27 February 2019

Please submit a CV and a cover letter, stating your motivation for applying and why you believe you are qualified for the position, to info.shpf@gmail.com

Only successful candidates will be contacted.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

## TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING**
**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019 .

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING"
The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**
**Administration Building**
**Rinas, Tirana**
**Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00** hrs on 1**8 March 2019.**
Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

## Rrëfehet modeli: Të rinjtë shqiptarë i shohin pasarelat si diçka momentale

# Klevis Troja:

# Modelingu nuk të ofron mundësi, do të zgjidhja basketbollin

*"Jam i përqendruar te qëllimet e mia, ja projektet e fundit"*

Egla Xhemali






Të jesh model nuk është më "e ndaluar". Ashtu si çdo profesion tjetër, ata që kanë zgjedhur këtë rrugë përballen me vështirësi, por që duken fare të vogla duke marrë parasysh pasionin e madh me të cilin punojnë. Klevis Troja vjen në "Gazeta shqiptare" në një rrëfim për sfidat e mëdha që ka pasur si model, bashkëjetesën mes dy pasioneve të forta, basketbollit dhe modelingut, për cilësitë që duhet të këtë vajza që do i rrëmbejë zemrën si dhe për projektet e fundit. Klevisi thotë se nuk është ndierë asnjëherë i paragjykuar dhe tregon se si arriti t'ia dilte në sfilatën e stilistit të famshëm italian Luca Paolorossi, edhe pse gjurin e kishte të dëmtuar. Troja ndan me ne edhe vështirësitë që vijnë nga rrethanat e ndryshme si dhe mospërkrahjen që has modelingu në Shqipëri. I pyetur se cila do ishte zgjedhja e tij mes modelingut dhe basketbollit, ai pohoi basketbollin. Për të, sporti sjell emocione të veçanta. Më tej, modeli qesh dhe na flet për vajzën ideale, që sipas tij duhet të përshtatet në karakter me të dhe të bien gjithmonë dakord për ushqimin. Për të gjithë ata që janë kuriozë për projektit e fundit të Klevisit, ju lajmërojmë se shumë shpejt do keni surpriza. Deri atëherë ju mbetet të prisni.

**Pse shihet si "i ndalur" modelingu për djemtë?**

Nuk mendoj se shihet si "i ndaluar", pasi jemi të vetëdijshëm që shumë të rinj po i futen rrugës së modelingut, por ndoshta ndikon çështja e mentalitetit.

**Je ndierë ndonjëherë i paragjykuar?**

Pjesën e paragjykimeve nuk e kam ndierë, sepse nuk kam bërë asnjëherë diçka ekstreme që të jetë jashtë natyrës sime.

**Sfida më e madhe me të cilën je përballur deri më sot?**

Sfidën më të madhe sa i përket modelingut, më është dashur ta kaloj para një viti, ku sapo kisha dëmtuar gjurin në një ndeshje basketbolli të Superligës dhe më duhej të isha pjesë e sfilatës së stilistit të famshëm italian Luca Paolorossi, që u mbajt në Pallatin Presidencial. Pavarësisht dhimbjeve të gjurit, në fund arrita t'ia dal dhe ta kaloja me sukses atë sprovë.

**Sa mundësi u ofron Shqipëria modelëve të rinj?**

Mundësitë janë të pakta, pothuajse zero, sepse nuk ka përkrahje dhe investim në këtë aspekt dhe të rinjtë shqiptarë e shohin thjesht si diçka momentale ose thjesht një hobi.

**Vendi më i vështirë për të realizuar një set fotografik?**

Atëherë, më shumë se sa vendi, punën e vështirësojnë rrethanat. Për shembull, mua personalisht më është dashur të xhiroj një reklamë në plazh, ndërkohë që ishte mars e mund ta imagjinoni vetë sakrificën dhe mundin në temperatura të ulëta.

**Një nga pasionet e tua më të mëdha është basketbolli. Nëse do të duhej të zgjidhje mes modelingut dhe basketbollit, cila do ishte zgjedhja jote?**

Nuk e mendoj dy herë, do zgjidhja gjithmonë basketbollin.

**Kur fitohet një ndeshje, çfarë mënyre zgjedh për ta festuar?**

Basketbolli është një sport që të fal shumë emocione dhe fitorja i dyfishon ato. Mënyra më e mirë për të festuar është duke u mbledhur me njerëzit më të dashur dhe duke kaluar mirë për orë të tëra.

**Si "u shpëton" vajzave që të kanë fiksim?**

Nuk jam i sigurt nëse fjala "shpëtoj" është e duhura për t'u përdorur në këtë rast. Unë si Klevis di vetëm të them që jam i përqendruar te qëllimet e mia dhe ajo që kërkoj unë.

**Çfarë cilësish duhet të këtë një vajzë që të të rrëmbejë zemrën?**

Kjo është një pyetje, të cilës nëse i hyjmë në detaje s'do mbaronim së foluri, por e rëndësishme është që të na përshtaten karakteret dhe të jemi në një mendje gjithmonë, kur bie fjala tek ushqimi. (qesh)

**Projektet e tua të fundit?**

Unë sapo përfundova një spot publicitar, një projekt të madh të një kompanie telefonike shqiptare. Në javët në vazhdim kam në plan një set fotografik me fotografin dhe talentzbuluesin Sonny K Elson, me të cilin kam nisur hapat e parë në rrugën e modelingut.



Pas krimit në familje, 44-vjeçari nuk u largua nga banesa, telefonoi policinë

# Vrau gruan, gardisti: Më gënjente, dyshoja se kur isha në punë takohej me njerëz të tjerë

## Alket Arapaj, në gjendje të rënduar psikologjike

TIRANË

Kohët e fundit bashkëshortja nuk ishte e sinqertë me mua. Ajo më gënjente dhe nuk më tregonte të vërtetën. Kur unë ikja në punë, dyshoja se takohej me njerëz të tjerë. Asnjëherë nuk më jepte një version për gjërat që e pyesja". Kështu ka deklaruar para oficerëve të policisë gjyqësore, gardisti Alket Arapaj, i cili mëngjesin e së hënës vrau me armën e shërbimit gruan e tij 36-vjeçare, Ervilma Seferi. Ndërkohë, mësohet se 44-vjeçari, baba i një vajze 3 vjeçe është shfaqur në gjendje të rënduar psikologjike në ambientet e Drejtorisë së Tiranës, atje ku mbahet i izoluar. Gjatë qëndrimit në dhomën e paraburgimit, ai ka shfaqur gjendje të rënduar emocionale, madje në disa raste ka goditur murin me kokë duke vënë në alarm rojet e sigurisë. Ndërkaq, gjatë marrjes në pyetje Alket Arapaj ka dhënë versione të ndryshme për motivin që e çoi deri në vrasjen e nënës së fëmijës së tyre të mitur. Ndër të tjera ai, është shprehur se bashkëshortja, Ervilma nuk ia dëgjonte më fjalën dhe kjo ka sjellë krimin e rëndë. Sipas hetuesve të çështjes, efktivi i Gardës së Republikës nuk ka dhënë detaje se çfarë ka ndodhur realisht mes tij e bashkëshortes mëngjesin e së hënës, por ka shfaqur shenja xhelozie. Deri tani, për grupin e hetimit, pista kryesore e krimit në familje është ajo për shkak të xhelozisë dhe për këtë gjë do të merren në pyetje edhe familjarët e viktimës. Pas krimit, 44-vjeçari nuk është larguar nga banesa e tij që ndodhet në zonën e Alliasit. Ai ka telefonuar policinë, të cilët bënë edhe prangosjen e tij. Sipas uniformave blu, krimi ka ndodhur në momentin kur Alket Arapaj do të shkonte të merrte detyrën në Gardën e Republikës.



Gardisti Alket Arapaj



Viktima Ervilma Seferi

**TELEFONATA**

Pas vrasjes së bashkëshortes, gardisti Alket Arapaj i ka telefonuar sallës operative të Policisë së Tiranës. "Kam vrarë gruan, hajdeni më arrestoni". Të alarmuar, efektivët e Komisariatit nr.4, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje. Më pas aty kanë mbërritur edhe oficerët e Krimeve të Rënda dhe ekspertë kriminalistë, që kanë nisur veprimet hetimore. 44-vjeçari akuzohet për veprën penale: "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare"

**VRASJA**

Sipas burimeve policore vrasja e 36-vjeçares Ervilma Seferaj ka ndodhur rreth orës 06:00 të së hënës në rrugën "Vangjel Capo", në zonën e Alliasit. "Shërbimet e Policisë të Komisariatit Nr.4, në bashkëpunim me SHÇBA arrestuan në flagrancë shtetasin A. A., 44 vjeç (punonjës në Gardën e Republikës). Rreth orës 06:00 të mëngjesit, në banesën e tij në Allias, ai dyshohet se ka vrarë me armën e shërbimit bashkëshorten, 36 vjeçe. Materialet iu referuan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare"-thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, burime për "GSH" pohuan se krimi ka ndodhur në banesën e çiftit, në dhomën e ndenjes. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, hetuesit e çështjes pohuan se krimi ka ndodhur pas një konflikti banal në çift, i cili ka degjeneruar deri në vrasje. Alket Arapaj, i cili akuzohet për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", ka qenë oficer në gradë prej 20 vitesh. Më parë ai ka qenë shoqërues personalitetesh dhe ka punuar në presidencë. Ai prej disa vitesh ishte pozicionuar tek njësia 3 tek pallati i Brigadave. Kjo ishte martesa e dytë e gardistit. Vrasja e 36-vjeçares ka tronditur fqinjët e çiftit, të cilët dje deklaruan për "GSH" se familja nuk kishte probleme dhe ishin një model në lagje. Ata ishin predikues të rregullt të fesë islame dhe gruaja ishte e mbuluar me shami.

## KPK e konfirmoi, beteja e prokurorit Adnand Kosova zhvendoset në KPA

TIRANË - Komisioneri Publik i është drejtuar Komisionit të Posaçëm të Apelimit ku ka ankimuar vendimin e marrë nga KPK për konfirmimin në detyrë të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme, Adnand Kosovës. Sipas Komisionerit Publik, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara, Adnand Kosova, nuk plotëson kushtet për konfirmimin në detyrë. "Komisioneri Publik, brenda afatit ligjor, ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, kundër vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Adnand Kosova, magjistrat/prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin e mësipërm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe mori në konsideratë rekomandimin e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për të paraqitur ankim, vlerëson se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, nuk plotëson kushtet për konfirmimin në detyrë", thuhet ndër të tjera në njoftimin e Komisierit Publik. Nëpërmjet këtij ankimi, Komisioneri Publik kërkon nga KPA të marrë në shqyrtim çështjen në seancë publike dhe, në përfundim të gjykimit, të ndryshojë vendimin nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova.

### KPA lë në fuqi vendimin e KPK për gjyqtarin e Kushtetueses

# Probleme me pasurinë e vajzës dhe dënimi i nipit "sekser", Gani Dizdari jashtë sistemit të drejtësisë

TIRANË - Gani Dizdari, i cili ka qenë pjesë e elitës së drejtësisë shqiptare, përfshi Hetuesinë, zv/Prokuror i Përgjithshëm, anëtar i Gjykatës së Lartë dhe së fundmi edhe gjyqtar i Kushtetueses është shkarkuar përfundimisht nga detyra. Vendimi është marrë nga Komisioni i Posaçëm të Apelimit që la në fuqi shkarkimin e datës 16 korrik të KPK-së. Pas këtij vendimi, ai do të duhet të largohet përfundimisht nga drejtësia. Me largimin e tij përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese, ky institucion mbetet vetëm me një anëtar të konfirmuar, Vitore Tushën. Gani Dizdari u penalizua për pasurinë dhe pastërtinë e figurës. Gjyqtari kushtetues u vendos në pozitë të vështirë për lidhjen e tij me nipin, i cili rezulton se është i dënuar për çështjen e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm në Gjykatën e Lartë, si dhe mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e disa pasurive të paluajtshme. Po ashtu edhe për një borxh që ia kishte marrë së bijës.



Gani Dizdari

Në raportin dërguar në KPK, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka arritur përfundimin se gjyqtari Gani Dizdari është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës për shkak të lidhjeve të ngushta me shtetasin A.L., i cili është dënuar në qershor të 2012-ës me vendim të formës së prerë për "ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike," vepër që e kualifikon këtë person si të përfshirë në krimin e organizuar. Nga hetimi administrativ i KPK-së, ka rezultuar se ndikimi i paligjshëm i personit të lidhur A.L. është ushtruar ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, gjatë periudhës kur gjyqtari Gani Dizdari ishte anëtari i saj. Përveç problemeve të konstatuara me kontrollin e figurës, KPK ka zbuluar dhe probleme me pasurinë e gjyqtarit Dizdari.



# Në "sitë" Hipoteka e Durrësit, shkarkohen gjashtë specialistë

TIRANË - Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka njoftuar dje të tjera shkarkime nga puna në Hipotekën e Durrësit. Në raportimin javor, Koordinatorja kombëtare e antikorrupsionit, Gjonaj tha se vijon puna dhe kontrollet dhe kontrollet intensive në Hipotekën e qytetit bregdetar, ndërsa bëri me dijelargimin e 6 punonjësve të tjerë për shkelje ligjore. Kjo masë vjen menjëherë pas shkarkimit të kreut të kësaj hipoteke, i cili u kap me zë dhe figurë në një bisedë me qytetarët duke mos iu shërbyer për hallet dhe shqetësimet që kishin adresuar tek kjo zyrë. "Bazuar në informacionet e marra mbi praktika abuzive, Task Force ka ushtruar kontroll tjetër në këtë zyrë dhe nga praktikat e monitoruara rezultojnë aplikime të trajtuara jashtë afateve, sistemi online nuk pasqyron situatën aktuale, është gjendur se ai nuk është administruar dhe përdorur në të gjitha fazat e tij, nuk është vepruar në përputhje me kërkesat për arkivimin e teknikave në zyrat e Hipotekës duke bërë referenca të shërbimeve të paarkivuara e duke sjellë pasoja në origjinën e pasurisë. Pas kësaj u vendos largimi për 6 specialistë të zyrës dhe vërejtje më shkrim për 10 të tjerë jurisë dhe hartografë, duke e cuar në total numrin e masave në 31 masa"- pohoi ministrja.

Publikohet raporti, Lleshaj: Nga Shqipëria, 81% më pak kanabis drejt Italisë në 2018-ën

# Zhduket kanabisi në Shqipëri, zyrtarja e SHBA: Do krijojmë SPAK që politika të mos mbrojë kriminelët

## *"Kapja e Balilit, Çekajt e Met Kananit të shërbejë si gur kilometrazhi në këtë përpjekje afatgjatë"*


Leyla Moses-Ones, e ngarkuara me punë në Ambasadën e SHBA-ve në Shqipëri


Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

**TIRANË**

Ulet në mënyrë drastike kultivimi dhe trafikimi i kanabisit në Shqipëri. Policia e Shtetit në bashkëpunim me GDF kanë publikuar raportin me shifrat e kultivimit dhe sekuestrimit për vitin 2018. Nga raporti rezulton se viti i kaluar shënoi nivelin më të ulët të kultivimit të kanabisit në vend. Zyrtarët e lartë të Guardia Di Finanza-s italiane, që kryen monitorimet përmes ajrit për më shumë se 187 orë fluturimesh, konfirmojnë se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në luftën kundër kultivimit të kanabisit. "Është konfirmuar ulje e plantacioneve, janë identifikuar vetëm 27, nga 88 që ishin në 2017. Tregohet një ulje domethënëse edhe e kanabisit të sekuestruar në Itali, me 81% brenda një viti", tha gjeneral brigade, Giuseppe Arbore. Në një aktivitet të titulluar "Për një Shqipëri pa kanabis", ambasadori i BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca, përgëzoi strukturat për evidentimin dhe goditjen e kultivimit të kanabisit. "Rezultatet janë mbresëlënëse, ulje drastike në kultivimin e kanabisit në Shqipëri. Gjithashtu, tregohet edhe një ulje e kanabisit që është sekuestruar në Itali", u shpreh Soreca. Ndërkaq, në këtë aktivitet që u mbajt ditën e djeshme në Tiranë ishte e pranishme dhe e ngarkuara me punë në Ambasadën e SHBA-ve në Shqipëri, Leyla Moses-Ones, e cila përgëzoi Shqipërinë për arritjet në betejën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ndërsa kërkoi që lufta të vijojë.

**DEKLARATA E ZYRTARES SË SHBA-ve**

Në konferencën "Për një Shqipëri pa kanabis", zyrtarja amerikane, Leyla Moses-Ones, vuri theksin në vijimin e luftës antikanabis në vend dhe në rëndësinë e vullnetit politik të palëve për të fituar në këtë drejtim. "Fakti që kemi fituar një betejë nuk do të thotë se fituam luftën. Lufta duhet të vazhdojë. Kultivimi dhe lëvizja e kanabisit janë vetëm një pjesë e problemit, tani duhen pengesa më të forta për të ndaluar që trafikantët ta shohin Shqipërinë si një mjedis lejues të aktivitetit të paligjshëm. Ky është vendi ku ruajtja e vrullit të reformës në drejtësi është absolutisht vendimtare. Trafikantët duhet të përballen me zinxhirin e plotë të drejtësisë nga arrestimi, te procedimi penal i drejtë e dënimi i duhur me burgim. Dhe njerëzit që drejtojnë këto rrjete duhet t'i frikësohen shumë", deklaroi e dërguara e SHBA-ve në Tiranë, ndërsa veçoi arrestimet e bujshme në kuadër të luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotive. "Kapja e Klement Balilit, Arbër Çekaj e Met Kananit duhet të shërbejnë si gur kilometrazhi në këtë përpjekje afatgjatë. Tani është në dorë të prokurorëve e gjykatave dhe sigurisht të vullnetit politik. SHBA-të ju mbështetin, por ne varemi nga vullneti juaj politik dhe guximi për të vijuar luftën për demokraci e shtet ligjor. Do vijojmë të mbështesim krijimin e SPAK e BKH për të siguruar që politika të mos luajë një rol në mbështetje të këtij aktiviteti të paligjshëm dhe as të mos përmbysë peshoren e drejtësisë në interes të kriminelëve. SHBA-të qëndrojnë krah për krah me Shqipërinë në këtë luftë. Trafikimi përbën kërcënim për sigurinë kombëtare e ndërkombëtare", u shpreh zyrtarja amerikane. "Ne duhet të ndjekim paratë e pista. Duhet të dërgojmë një mesazh të qartë se Shqipëria nuk është e nuk do të jetë kurrë një mjedis që lejon veprimtari të paligjshme kriminale. Ulja e prodhimit dhe arrestimet të pasohet me sekuestrim të pasurive të kriminelëve", - vijoi më tej e dërguara e SHBA-ve në Tiranë.

**MINISTRI LLESHAJ**

Në aktivitetin e djeshëm, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj foli për rezultatet e arritura nga Shqipëria në luftën ndaj kultivimit të lëndëve narkotike. "Historia e kanabisit në Shqipëri është relativisht e re. Ajo ka nisur në fillim të viteve '90-të, ka kaluar nëpër një trajektore plot oshilacione, ka prodhuar lajme botërore me Lazaratin dhe ka mbërritur sot në nivelet më të ulëta. Për vitin 2018, sipas të dhënave zyrtare të PSH, niveli i kultivimit të kanabisit në Shqipëri është në minimumin historik. Siç u dokumentua gjatë prezantimeve të mëparshme, ky sukses konfirmohet plotësisht edhe nga bregu përballë, Italia fqinje. Në vitin 2018, sasia e kanabisit të kapur në Itali me origjinë nga Shqipëria është 81% më e ulët se në vitin 2017!", - tha Lleshaj. Duke shtuar se për të arritur deri në këtë ditë është dashur një punë e madhe falë së cilës janë goditur rrjetet dhe grupet funksionale kriminale që operojnë në këtë fushë, Lleshaj gjeti rastin të falënderonte edhe partnerët që e kanë mbështetur Shqipërinë. "Në mënyrë të veçantë, sot dëshiroj të falënderoj qeverinë italiane, strukturat e Rojës Financiare të Italisë dhe policinë italiane për finalizimin me sukses të plotë të projektit të mbështetjes me vëzhgim ajror për zbatimin e strategjisë kundër kanabisit (SANCAS). Viti 2017 ishte një sukses i rëndësishëm. Ndërsa 2018-ta është një kulm historik suksesi. Zhvendosja e objektivit të luftës nga bimët te kriminelët është thelbi i suksesit", - u shpreh ndër të tjera Lleshaj.

## "Shqipëria pa kanabis", reagon ish-ministri Xhafaj: Pas 25 vitesh s'jemi më vend origjine


Ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

**TIRANË** - Ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj ka reaguar me anë të një postimi në "Twitter" për raportin e publikuar dje me temë "Një Shqipëri pa kanabis". Sipas tij, pas 25 vitesh, Shqipëria nuk rezulton të jetë më si vend origjine i prodhimit dhe i trafikimit të kanabisit. Në reagimin e ish-ministrit Xhafaj thuhet se shifrat kokëforta flasin vetë dhe konfirmojnë edhe njëherë punën që është bërë në këtë drejtim, ndërsa një falënderim special kishte edhe për ish-bashkëpunëtorët. Raporti për 2018-ën, edhe pse u prezantua sot nga ministri Sandër Lleshaj, është punë e paraardhësit të tij në këtë post, Fatmir Xhafajt, i dorëhequr në fund të vitit të kaluar.

**1.**"Një Shqipëri pa kanabis! Prezantimi sot publikisht (më mirë vonë se kurrë!) i rezultateve antikanabis '18, konfirmimi më i mirë i realitetit historik. Pas 25 vitesh, s'jemi më vend origjine i prodhimit e trafikimit të kanabisit! Krenar për çfarë bëmë, ndër të tjera, në këto vite!

**2.**Me të njëjtët policë, buxhet, mjete, asistencë, në të njëjtin territor ndryshuam një realitet e krijuam model të krahasueshëm me Evropën! Fuqia e vlera qëndron te njerëzit, reformat e mëdha që PS ideoi e udhëheq për të ndërtuar shtet e drejtësi në vend!

**3.**Krenar për rezultatet e antitrafikimit në 2018-ën. 80% ulje e trafikut me vendin fqinj krahasuar me 2017. Luftë pa kompromis e rezultate të shkëlqyera ndaj grupeve kriminale. Shifrat kokëforta flasin vetë! Fjalët sado të bukura, i merr era. Forca e ligjit në veprim e mbi të gjithë!

**4.**Respekt dhe mirënjohje pafund bashkëpunëtorëve të mi, sakrificës së policëve të thjeshtë në territor dhe veçanërisht ekipit drejtues të Policisë së Shtetit! Njerëz që e duan vendin e tyre, të ardhmen e tij!

**5.**Turp i madh për ata, që për vite të tëra i dhanë vendit një imazh negativ, rinisë modelin e keq e krimit të organizuar pushtet e fuqi financiare! Nëse s'kërkojnë dot falje, të paktën të heshtin! Përçmim për të gjithë ata që kanë hedhur baltë mbi përpjekjet tona në këtë betejë!

**6.**Sot Policia e Shtetit, e besueshme dhe bashkëpunuese për partnerët ndërkombëtarë. Ndërsa dje, kur shefi i opozitës së sotme ishte drejtuesi politik i kësaj organizate, këta partnerë "përshëndeteshin" me plumba që zbrazeshin nga bastioni i hashashit politik të kësaj opozite", thuhet në postimin e ish-ministrit.



### Kapen 1 ton hashash në Kapshticë, 2 shoferë në pranga

Rreth 1 ton lëndë narkotike mendohet të jetë sasia e drogës së gjetur në njërin prej kamionëve që u bllokuan në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës, ndërkohë që është duke u kontrolluar edhe kamioni i dytë. Dy automjetet e transportit të mallrave të ngarkuar me krunde u bllokuan në kufi, pasi policia ra në gjurmë të ngarkesës së dyshimtë që ata po transportonin.

Dy shoferë janë vënë në pranga deri më tani. Ata janë Zija Hidri dhe Ardian Sako. Dy kamionët udhëtonin nga kryeqyteti në drejtim të Greqisë, ndërkohë që destinacion final kishin Turqinë. Procesi i skanimit për kamionin me targa AA 874 UZ zbuloi edhe sasinë e konsiderueshme të lëndës narkotike, e cila ishte ambalazhuar në thasë, ndërkohë që specialistët e antidrogës, por edhe forca të shumta policie janë duke kryer veprimet në territorin doganor.

### Shpërthen goma e mjetit, 20 persona transportohen në spital

## Aksident i rëndë në rrugën Shkup-Tetovë: Rrokulliset autobusi, kalimtarët në ndihmë të pasagjerëve


Aksidenti i autobusit në rrugën Shkup-Tetovë

Një aksident i rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme, rreth orës 17:00, në autostradën Shkup-Tetovë, te fshati Llaskarcë i komunës së Sarajit, ku është rrokullisur një autobus. Rreth 20 persona të aksidentuar në autostradën Shkup-Tetovë janë transportuar deri më tani në spitalin "8 shtatori" në Shkup, njoftoi para pak çastesh televizioni Alsat. Të gjithë udhëtarët kanë mbetur të ngujuar brenda autobusit dhe po presin ndërhyrjen e ekipeve të shpëtimit. Kalimtarët e rastit dhe qytetarët, të cilët gjenden në vendngjarje janë mbledhur grup dhe po mundohen që të rrokullisin autobusin, për të mundësuar tërheqjen e udhëtarëve që kanë ngelur brenda autobusit të nxirren jashtë. Mjete të rënda janë sjellë në vendngjarje për të mundësuar që të lëvizin autobusin, kujtojmë që autobusi është rrokullisur në kilometrin e shtatë të autostradës Shkup-Tetovë. Ekipet e ndihmës së shpejtë janë mbledhur në vendngjarje nga ku po ndihmohen nga kalimtarët e rastit dhe banorët përreth, për të nxjerrë nga autobusi udhëtarët, të cilët kanë ngelur brenda, dyshohet edhe për të vdekur. Deri tani, tri ambulanca dhe disa ekipe policore si dhe një ekskavator privat janë angazhuar në shpëtimin e personave. Patrullat policore kanë bllokuar dhe siguruar perimetrin e aksidentit. Zv. ministri i Brendshëm, Agim Nuhiu është duke shkuar në vendin e ngjarjes. Akoma nuk dihet numri i udhëtarëve si dhe nëse ka apo jo të lënduar rëndë ose viktima gjatë këtij aksidenti. Ekipet mjekësore tanimë kanë filluar të transportojnë disa të lënduar në Qendrën Klinike të Shkupit. Sipas dëshmitarëve thuhet se shkak i aksidentit ishte plasja e gomës pas së cilës autobusi ka përfunduar në korsinë e kundërt të autostradës. Informatat e para thonë se bëhet fjalë për autobusin e kompanisë Durmo Turs. Për shkak të aksidentit, rruga Shkup-Tetovë për momentin është e bllokuar.

### Eurodeputeti gjerman i kërkon Kosovës heqjen e tarifës për mallrat

# Dialogu me Serbinë, Hashim Thaçi takon ambasadorin e SHBA-ve

## *Putin, letër Vuçiçit: Taksa ka cenuar jetën e serbëve*

Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës, ka takuar ditën e djeshme ambasadorin e SHBA-së, Philip S. Kosnett teksa ka biseduar për tema të nxehta, e veçanërisht atë të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Thaçi ka theksuar se miqësia me SHBA është e përhershme dhe thelbësore për realizimin e qëllimeve strategjike për integrim në strukturat euroatlantike. "Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndajnë vlera, parime dhe synime të përbashkëta. Në këtë rast, synimi ynë i përbashkët është të ndërtojmë paqe e stabilitet të qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon, si parakusht për zhvillim e prosperitet të vendit tonë. Çelës për paqen është arritja e një marrëveshjeje paqësore, gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë",-ka thënë presidenti Thaçi. Presidenti dhe ambasadori Kosnett thanë mes tjerash se thelbësore është të largohen të gjitha pengesat për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe t'i hapet rrugë marrëveshjes paqësore. "Partneriteti dhe miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është jetësor për Kosovën. Kosova ka arritur kaq larg falë përkrahjes së gjithanshme të Shteteve të Bashkuara", ka shtuar Thaçi. Ndërkaq eurodeputeti gjerman dhe raportuesi për Serbinë në parlamentin Evropian, David McAllister, ka kërkuar nga qeveria e Kosovës anulimin e vendimit për taksën ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. "Vendimi i qeverisë së Kosovës për të aplikuar taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina është një shkelje e qartë e CEFTA-s dhe e marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit. Unë i bëj thirrje qeverisë në Prishtinë që ta anulojnë këtë vendim në mënyrë që, shpresoj, që dialogu të vazhdojë",-ka thënë McAllister, raporton 'Tanjug'. Ai shtoi, gjithashtu, se tashmë BE-ja e ka bërë të qartë se nuk mund të ketë arritje të një marrëveshje ligjërisht të obligueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pa largimin e taksës. "Unë e kuptoj se të dyja palët kanë shqetësime, e kuptoj se nuk është e lehtë, por, gjithashtu, dua të theksoj se dy presidentët Aleksandar Vuçiç dhe Hashim Thaçi e kanë ngritur dialogun në nivel të ri", ka thënë McAllister. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin i ka dërguar dje një letër Serbisë në të cilën ka mbajtur qëndrimin e tij për çështjen e Kosovës. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç ka marrë nga ambasadori i Rusisë në Beograd, Aleksandar Çepurin, një letër të dërguar nga presidenti i Rusisë, Vladimir Putin para ditës së pavarësisë së Serbisë. Në letrën e dërguar homologut serb, shefi i Kremlinit pohoi se taksa e Kosovës mbi mallrat serbe ka cenuar jetën e qytetarëve serbë, të cilët jetojnë në tokën e Kosovës. Letra e plotë e Putinit: "I nderuari president, pranoni përshëndetje të ngrohta me rastin e festës së juaj kombëtare - ditës së shtetit të Serbisë. Në Rusi vlerësohen lartë raportet e partneritetit strategjik me Serbinë. Me kënaqësi ju them se bashkëpunimi i shteteve tona do të vazhdojë në mënyrë dinamike në fusha të ndryshme. Dua që edhe njëherë t'ju falënderoj për pritjen e ngrohtë ndaj meje dhe delegacionit rus në Beograd. Llogaris në vazhdimin e dialogut tonë konstruktiv dhe vazhdimin e punës në agjendën e përbashkët ndërkombëtare. Sinqerisht ju uroj shëndet të mirë dhe suksese, kurse popullit vëllazëror serbë - mirëqenie dhe prosperitet", thuhet në vazhdim të letrës së Putinit. Presidenti i Serbisë, Vuçiç ka falënderuar Putinin për urimet e tij. Kurse, gjatë takimit me ambasadorin Çepurin kanë shqyrtuar temat e bashkëpunimit bilateral dhe marrëveshjet e diskutuara gjatë vizitës së fundit të Putinit në Beograd. Ambasadori Çepurin në emër të Putinit ka përcjellë qëndrimin e presidentit në lidhje me çështjen e Kosovës duke thënë se vendimi për taksë ndaj mallrave serbe është hap i papërgjegjshëm nga Prishtina që ka cenuar dialogun dhe mbi të gjitha jetën e serbëve në Kosovë",-thuhet në letër.


Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Philip s.Kosnett

**HASHIM THAÇI**
"Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndajnë vlera, parime dhe synime të përbashkëta. Në këtë rast, synimi ynë i përbashkët është të ndërtojmë paqe e stabilitet të qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon, si parakusht për zhvillim e prosperitet të vendit tonë. Çelës për paqen është arritja e një marrëveshje paqësore, gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare mes të Kosovës dhe Serbisë", - tha Thaçi.

SHKURT

### Cipras e Zaev propozohen për çmimin "Nobel për Paqe"

Kryeministri i Greqisë, Aleksis Cipras dhe homologu i tij i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev janë propozuar zyrtarisht për çmimin "Nobel për Paqen". Lajmi bëhet i ditur nga agjencitë shtetërore të lajmeve në Athinë dhe Shkup. Gazeta greke Ekathimerini shkruan se ishte Parlamenti Europian ai që bëri propozimin për Cipras dhe Zaev për kontributin e tyre për përpjekjet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për emrin, një problem ky i mbartur prej dekadave. Pas miratimit të marrëveshjes së Prespës për ndryshimin e emrit në Maqedonia e Veriut dhe një protokolli për pranimin e saj në NATO, të dy vendet si Maqedonia dhe Greqia tani duhet t'i dërgojnë një letër të përbashkët, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres.

### NATO: Ekziston një marrëveshje, FSK s'mund të shkojë në veri

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg i është kundërpërgjigjur deklaratës së kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj se nuk ka jug dhe veri në Kosovë. Stoltenberg ka rikujtuar se ekziston një marrëveshje në Bruksel për këtë çështje dhe ajo duhet të respektohet, raporton Telegrafi. "Kemi një marrëveshje, marrëveshjen e Brukselit 2013 që thotë se FSK-ja nuk mund të shkojë në veri pa lejen e KFOR-it, dhe ajo marrëveshje është ende e vlefshme dhe duhet respektuar",-tha Stoltenberg. Sipas tij, shumë aleatë pajtohen se transformimi i FSK-së në Ushtri nuk është bërë në kohën e duhur. Megjithatë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka thënë NATO do të mbetet në Kosovë me trupat e KFOR-it, dhe është e bazuar në mandatin e OKB-së. Sipas tij, prezenca e KFOR-it ka pasur rol të rëndësishëm për stabilitetin në Kosovë dhe tërë rajonin.

### Emri i ri i Maqedonisë, tabelat rrugore do të jenë edhe në shqip

Tabelat me mbishkrimin "Mirë se vini në Republikën e Maqedonisë së Veriut" e shkruar edhe në shqip do të vendosen në pikat kufitare, me përjashtim të rajoneve ku shqiptarët nuk përbëjnë 20 për qind. Megjithatë në shumicën e vendkalimeve kufitare do të vendosen tabelat e reja në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht. Në përputhje me ligjin për gjuhët, doganat e Maqedonisë së Veriut tabelat e reja do t'i vendosin në pikat kufitare Bllacë, Qafë Thanë, Tabanoc, Jazhincë dhe pikat e tjera ku shqiptarët në ato zona përbëjnë mbi 20 për qind. Kjo masë duhet të hyjë në fuqi brenda tre ditëve dhe të vendosen tabelat. Nga ana tjetër, qeveria në Maqedoni ka miratuar formimin e grupit të punës ndërministror për zbatimin e ligjit për gjuhët. Sipas njoftimit të qeverisë, ky ekip do të përkujdeset dhe ka kompetenca për përgatitjen e planit aksional për zbatimin e ligjit në një afat prej 15 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit qeveritar. Po ashtu ndër detyrimet do të jetë edhe ndjekja e dinamikës për realizimin dhe implementimin e planit aksional, ndjekjen e institucioneve dhe rekomandimet për të zbatuar ligjin, si dhe masa të tjera. Pjesë e këtij ekipi janë: sekretari i përgjithshëm i qeverisë, zëvendës-sekretari, sekretari shtetëror i Ministrisë së Drejtësisë, sekretari shtetëror i Ministrisë së Financave, sekretari shtetëror nga sekretariati i Marrëveshjes së Ohrit, sekretari i sekretariatit për drejtësinë, përfaqësues i kabinetit të kryeministrit dhe përfaqësues i Kuvendit.

Traktati i Atlantikut të Veriut, aleanca që po mbron vendin nga lufta

# Pas 70 vitesh, bota ka ende nevojë për NATO-n

## *Marrëveshje ushtarake dhe politike, anët e pathëna të organizatës*

Berlin - Në prill të këtij viti, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, do të festojë ditëlindjen e saj të 70-të. E themeluar në vitet e hershme të Luftës së Ftohtë, ajo është po aq e rëndësishme edhe sot, kur shumë njerëz mendojnë se rendi ndërkombëtar është tronditur sërish. Në fakt, nëse NATO nuk do të ekzistonte, ata që janë në favor të një bote të lirë, do të duhej ta shpiknin atë. Ndërsa qëllimi kryesor i aleancës mbetet garantimi i sigurisë së anëtarëve të saj, ajo nuk ka qenë kurrë një aleancë e pastër ushtarake. Ajo është, gjithashtu, një aleancë politike, bazuar në aspiratat e përbashkëta të anëtarëve të saj, të cilët, siç e thotë Traktati i NATO-s, "janë të vendosur të mbrojnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të saj, bazuar në parimet e demokracisë, lirisë individuale dhe sundimit të ligjit". Sot këto parime, ndodhen nën një sulm. Agresioni rus në Evropën Lindore, sjellja agresive e Kinës në Detin e Kinës Jugore, terrorizmi i Shtetit Islamik, që përhapet nga Lindja e Mesme në kryeqytetet e Evropës, regjimet autoritare që zhvillojnë armë bërthamore -sfida këto të ndryshme, por që kanë një gjë të përbashkët: Ato lindin nga aktorë, që kundërshtojnë rendin aktual ndërkombëtar. Ata përpiqen të minojnë, ose madje edhe të ndryshojnë rregullat, që kanë qeverisur epokën e demokracisë dhe prosperitetit, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Për t'i tejkaluar këto sfida, demokracitë e NATO-s, duhet të qëndrojnë të bashkuara. Kolektivisht, ne jemi më të fortë se sa do të ishte veçmas cilido prej nesh. Prandaj, që nga viti 2014, kur Rusia pushtoi Ukrainën, NATO është përshtatur me situatën në fjalë - siç ka bërë shumë herë gjatë historisë së saj. Në mesin e 29 shteteve sovrane, me kultura dhe pikëpamje të ndryshme politike, një përshtatje e tillë do të jetë gjithmonë e ndërlikuar dhe ndonjëherë kaotike. Por aftësia e NATO-s për të ndryshuar prioritetet dhe strategjitë e saj, siguron që aleanca t'i qëndrojë provave të kohës. Dhe rezultatet janë të dukshme. Së pari, të gjithë anëtarët evropianë të NATO-s, i kanë rritur shpenzimet e tyre ushtarake. Për shembull, buxheti gjerman i mbrojtjes, është rritur me 36 për qind, krahasuar me kohën kur unë kam marrë detyrën në fundin e vitit 2013. Ne ende kemi më shumë për të bërë, për të ndarë barrën në aleancë, dhe jemi të përgatitur të bëjmë më shumë. Por, gjithashtu, duhet të mos harrojmë, se ndarja e barrës nuk është vetëm për para, por edhe për aftësitë dhe kontributet. Gjermania është në këtë plan, kontribuesja e dytë më e madhe në NATO, dhe krenare që do të udhëheqë Task Forcën e Përbashkët të NATO-s të Gatishmërisë së Lartë. Ndërkohë, NATO ka rritur praninë e saj në Evropën Lindore, luan një rol aktiv në trajnimin e forcave irakiane të sigurisë, si dhe ndihmon në mbikëqyrjen e luftës kundër Shtetit Islamik, vazhdon të mbështesë qeverinë afgane, dhe zhvillon partneritetet e saj me vende që kanë një vizion të ngjashëm si Australia dhe Japonia, përveç shumë gjërave të tjera. Në përmbushjen e 3 detyrave të saj kryesore - mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe partneriteteve - aleanca është një gur i pazëvendësueshëm për një rend ndërkombëtar që favorizon lirinë dhe paqen. Mbi të gjitha, NATO nuk është një organizatë trans-atlantike vetëm në emër. Ajo përfaqëson një lidhje të veçantë, madje edhe emocionale midis kontinenteve amerikane dhe evropiane. Për një gjerman, imazhet e rënies së Murit të Berlinit, janë të lidhura ngushtë me aleancën, dhe vendi im është veçanërisht mirënjohës për sigurinë dhe mundësitë që NATO ka ofruar për dekada të tëra. Pra, përveç përfitimeve praktike nga bazat, strukturave dhe trupat, NATO ka një vlerë në vetvete. Ndoshta përfitimi më themelor i NATO-s, është se ajo siguron besueshmëri në një botë të pasigurtë. Angazhimi ynë i patundur ndaj nenit 5, dispozita e mbrojtjes kolektive të traktatit të NATO-s, bën që siguria jonë e përbashkët të jetë vërtet e pandashme. Ne do të ndihmojmë aleatin tonë më të dobët, ashtu siç e kemi ndihmuar më të fuqishmit duke iu referuar nenit 5 - për herë të parë dhe të vetme në historinë e NATO-s - pas 11 shtatorit 2001. Pra, është mirë diçka e mirë që Bashkimi Evropian, po ndërmerr hapa të rëndësishëm për të rritur aftësitë e tij ushtarake. Nëse anëtarët e unionit, arrijnë të harmonizojnë strategjitë e tyre të mbrojtjes dhe përgatitjes ushtarake, dhe duke i ndërthurur forcat e tyre të armatosura, atëherë e gjitha kjo do të shtojë forcën e NATO-s. Dhe një NATO më e fortë, do t'i shërbejë interesave të sigurisë të të gjithë anëtarëve. Mbi të gjitha, ajo do të dërgonte një sinjal të qartë tek ata që e kundërshtojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla: Ne aleatët transatlantikë, jemi të gatshëm të mbrojmë tokën, njerëzit dhe lirinë tonë.

Nju Jork Tajms - Bota.al



Selia qendrore e NATO-s

## Shokon gazetari me librin e tij: 80 % e priftërinjve janë gei



Të paktën 80 % e priftërinjve të Vatikanit janë gay, sipas një libri të ri, i cili zbulon marrëdhëniet sekrete, prostitutat meshkuj dhe hipokrizinë e pretenduar nga shumica e anëtarëve anti-gai të Kishës Katolike. Libri i ri i gazetarit francez Frederic Martel "Në brendësi të Vatikanit" pretendon se shumica e priftërinjve homofobë janë gei. Në librin me 570 faqe detajohen edhe preferencat brenda tyre, siç është pagesa e prostitutave meshkuj, apo edhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Pretendimi skandaloz i Martel vjen pasi kaloi 4 vite duke intervistuar të paktën 1500 njerëz, përfshirë këtu 200 priftërinj, 41 kardinalë, roje dhe persona të tjera në Vatikan. Martel, i cili ishte edhe një këshilltar brenda qeverisë franceze, vizitoi vazhdimisht Romën dhe shpeshherë qëndroi në Vatikan apo edhe vende të shenjta në Romë.

## NJË MUR UJI PËRFSHIN SËRFISTIN, SHPËTIMI I VËSHTIRË MES DALLGËVE

**Një dallgë gjigande ka përfshirë sërfistin 41 vjeçar amerikan, Toby Cunningham, në brigjet e Nazare, në Portugali. Sportisti ka humbur ekuilibrin teksa po përpiqej ta kalonte dallgën me tavolinën e tij, duke u mbuluar nga një mur i vërtetë uji. Motorët e ujit rrendën për ta shpëtuar, duke u përpjekur të arrinin Cunningham, por dallgë akoma më të mëdha kanë ngadalësuar operacionin. Pas disa minutash ekipet e shpëtimit arritën të gjejnë dhe ta shpëtojnë.**




SHKURT



### Rusia paralajmëron SHBA për Venezuelën: Mos ndërhyni

Policia indoneziane ka kërkuar falje për përdorimin e një gjarpri për të frikësuar një hajdut të dyshuar, pasi pamjet shqetësuese u publikuan 'online'. Oficerët e policisë në video shfaqen te qeshin, ndërkohë që një hetues hedh gjarprin mbi një burrë të prangosur që ulërinte nga frika. "BBC" raporton se ngjarja ka ndodhur në rajonin e Papuas në Indonezi. Shefi i policisë lokale tha se ishte joprofesionale, por e mbrojti si praktikë, duke thënë se gjarpri nuk ishte helmues. Aktivistja e të drejtave të njeriut, Veronica Koman, i publikoi pamjet e rënda në faqen e saj në "Twitter" me pretendimin se autoritetet e kishin vendosur një aktivist që mbështet pavarësinë e Papuas në një qeli me një gjarpër. Në video dëgjohet zëri i dikujt që kërcënon të pandehurin se do t'ia vendosë gjarprin në gojë dhe poshtë pantallonave. Raportimet për abuzime me të drejtat e njeriut në Papua, ku separatistët prej kohësh kërkojnë pavarësinë në Indonezi janë të shpeshta.

### Kaliforni, policia vret një reper me ngjyrë që po flinte

Policia kaliforniane e Six Vallejo, në San Francisco, ka vrarë një reper 20-vjeçar, me ngjyrë, teksa flinte në makinën e tij jashtë një Taco Bell, një rrjet fast food-esh meksikane. Lajmin e bëjnë të ditur autoritetet amerikane. Viktima quhej Willie McCoy. Familja e tij e ka denoncuar si një vrasje me sfond racist, duke nënvizuar që nuk ka asnjë justifikim për përdorimin e forcës kundër një personi që fle dhe nuk përbën kërcënim. Sipas versionit të policisë, policët kishin shkuar për të kontrolluar McCoy pasi një punonjës i Taco Bell kishte njoftuar policinë, që një njeri kishte mbështetur kokën mbi timonin e makinës së tij jashtë lokalit. I riu ndodhej në veturë me dyert e mbyllura dhe nuk i është përgjigjur thirrjes së parë të policisë. Ne preher ai mbante një armë.

LIBRI

# Azis Beu dhe Hëna, një histori nga vitet 1930

*Bashkim Hoxha boton romanin "Kronikat e mjegullës"*

Fatmira Nikolli

Ka mjaft mjegull në shkrimin e historisë sonë, ka mjaft trukime. Në shumicën e rasteve historia e shkuar është shkruar për t'u shërbyer interesave të ditës dhe kjo ka sjellë mjaft gjëra të paqarta, mjaft mjegull në këto kronika". Bashkim Hoxha e shpjegon edhe kështu raportin tonë me historinë, teksa do vijë para lexuesit me një roman që zhytet thellë në kohë.

Janë vitet 1930, Shqipëria drejtohet nga Zogu, shteti po rreket të marrë tiparet moderne duke lënë pas 500 vitet nën Perandorinë Otomane.

Romani nis pothuajse brutalisht, sjell një ndjesi të "frikshme" për shkak të një gjendjeje perverse dhe banale që pothuaj duket se e penalizon vetë romanin. Por sapo mendon se është i rëndë, një faqe më tej, shpërfaqen reale e të fortë, të ashpër e krenarë, të pagdhendur e të papjekur, të zotë e zgjuar, zengjinë e fshatarë, profilet e burrave shqiptarë. Diku-diku janë krejt, të zakonshëm, mandej tërësisht atipikë, diku janë heronj e matanë imoralë, të pagdhendur. Ai duket se ridimensionon një histori, duke dashur të vërë përballë jetët njerëzore dhe madje anët e të njëjtit njeri, ku qëndrojnë përkrah ana njerëzore, banale, brutale ndaj historisë së trukuar e monumentale.

E ka titulluar "Kronikat e mjegullës" dhe ndjen në të një atmosferë shqiptare tipike për kohën. Në një farë mënyre, Hoxha sjell këndvështrimin e tij personal që i është rrënjosur mbi historinë e kohës. Thotë se një vështrim të tillë i ka sjellë edhe letërsia në përgjithësi. "Por, përveç këtij këndvështrimi, letërsia ofron edhe një mënyrë tjetër për ta kundruar historinë si një jetë njerëzore, madje edhe në mënyrë anekdotike. Pikërisht kjo mënyrë e të vështruarit ndryshe të historisë nga letërsia më ka ngacmuar prej kohësh për të shkruar këtë roman. Kam katër vjet që merrem me të", - ka thënë Hoxha.

Shkrimtari, gazetari dhe dramaturgu që drejton Teatrin "Aleksandër Moisiu" mendon se tri sfidat kryesore gjatë shkrimit të romanit kanë qenë pikërisht, përplasja me këndvështrimin e historisë me të cilën na kanë indoktrinuar deri tani, krijimi i raportit të historisë me jetën e thjeshtë dhe banale njerëzore dhe sfida e tretë ka qenë që e gjithë kjo të vijë përmes letërsisë dhe këtu e ka ndihmuar shumë "Dekameroni" dhe Konica.




"Romani 'Kronikat e mjegullës' jep mundimet shqiptare nën atmosferën e viteve '30, me ironi dhe ndërgjegje se si e kaluara mbetet për individin shqiptar aq e afërt në psikozë, mentalitet, përballë pushtetit, parasë dhe seksit, nga njerëzit e rëndomtë deri në autoritetet drejtuese, ose asaj që ashtuquajmë - elitë", shkruan gazetarja Violeta Murati në një bisedë të bërë me të.

Romani është i ndarë në "kapituj" që mbajnë emërtesa burrash e profile burrash. Mbi dhjetë portrete meshkujsh, për secilin nga një karakter e nga një qëllim. Kur pyetet se pse e ndan kaq shumë këtë histori me shqiptarët burra ai ka thënë se ka qenë e qëllimshme, por kjo ka ardhur si pjesë e natyrshme e historisë sonë. "Në rreshtin e parë kanë qenë gjithmonë burrat, vendimet merreshin në logun e burrave, vendimet e tyre i kanë dhënë tonin jetës njerëzore në përgjithësi. Me sa duket, në këtë aspekt kam respektuar një realitet historik. Azis beu na vjen si protagonist, duke ndjekur sagën e transformimit të tij - pothuaj e një politikani sot, që nuk shfaq kurrë pendim, ndërgjegje, duke ndërtuar një botë njerëzore me të cilët nuk duhet të merremi seriozisht". Por ai mohon të ketë qenë alibi e shkrimtarit për të justifikuar romanin apo moralin personal. "Azis beu dhe Hëna janë dy personazhet kryesorë rreth të cilëve vërtitet historia e mbushur me dashuri dhe armiqësi. Janë personazhe që unë i dua, për faktin se nuk mund të thuash se cili është i mirë apo cili është i keq. Janë rrethanat që i bëjnë ata të duken të këqij apo të mirë".

Duke qenë se atmosfera e romanit na çon në vitet '30, e gjen edhe personazhe realë si Konica, në të ndjehet atmosfera ironike si te Doktor Gjilpëra, tani jo murtaja fizike, por ajo mentale e drejtpërdrejtë ku, për të kërkuar se kush janë shqiptarët ai bën një "bisedë" me Konicën dhe Fishtën, Krist Malokin e Mbretin Zog. "Konica ka qenë frymëzimi im. Vështrimet e tij kontroverse dhe realiste gjithmonë më kanë ngacmuar, por në këtë roman më ka pëlqyer edhe fakti se ai dhe personazhe të tjerë historikë janë vetëm figurantë të historisë që përjetojnë personazhet e tjerë letrarë dhe jo historikë. Unë e besoj se 'çdo njeri është i rëndësishëm në jetën e tij"- thotë Hoxha.

**VLERËSIMET**

Meqë kam patur fatin ta lexoj dorëshkrim, dëshiroj të them që kemi të bëjmë me një roman krejt të veçantë në letrat shqipe, por edhe në galerinë e pasur të Bashkim Hoxhës. Kësaj here jemi në një roman breznish, ku historia politike e shekullit XX rrëfehet me mjaft mjeshtëri, guxim, madje pa droje për të shembur idhujt. Ky libër nuk duhet të mungojë në bibliotekë, ndërkohë që nuk lexohet, por përpihet me një frymë", ka shkruar Kel Demi. Ndërsa sipas Rezarta Reçit, romani ka një "ide të guximshme, e realizuar zhdërvjellshëm e me kujdes në një rrem të bukur e të pazakontë ku historia e popullit tonë ngrihet e bie bashkë me heronjtë e vet, siç ka ndodhur realisht nga njëra kronikë tek tjetra, nga njëra stinë politike tek tjetra për fatin tonë të keq historik, por aq fatmirë për shkrimtarin Bashkim Hoxha që ka mundësi të luajë me alën, idenë, gjuhën e zgjedhur, mjetet rrëfimtare ku dominon ironia".

## PAS 83 VJETËSH NË BUKURESHT RIBOTOHET REVISTA "ALBANICA"

Ditët e fundit ka dalë nga shtypi revista "Albanica", revistë shkencore dhe kulturore, organ i Shoqatës Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë. Emri i revistës ringjallet pas 83 vjetësh. Dr. Anton B.I. Balota, në vitin 1936, botoi revistën "Albanica" në Bukuresht, një revistë që propozonte, atëbotë, të ishte një nismëtare në filologjinë shqiptare. Autori planifikoi të botonte dhe vëllime të tjera, të cilat, përpos problemeve teorike të filologjisë shqiptare, do të ofronin më shumë informacion në lidhje me Shqipërinë dhe shqiptarët, në lidhje me të kaluarën dhe të tashmen e tyre si dhe tekste popullore apo nga letërsia e lëvruar, të përkthyera në rumanisht, studime përshkruese estetike të tekstit, gramatikën e dy dialekteve të gjuhës shqipe, të shoqëruar me fjalorë etj. Fatkeqësisht, kjo nismë nuk pati vazhdimësi... Pas 83 vjetësh, me një frymë të re, rimerret ky projekt i pezulluar në histori. Qëllimi i ringjalljes së "Albanica-s" është botimi i teksteve të rëndësishme, shkruar nga autorë rumunë dhe shqiptarë, por edhe nga studiues të tjerë të huaj, në lidhje me komunitetin shqiptar të Rumanisë dhe personalitetet e tij, rreth gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare, rreth Rumanisë dhe marrëdhënieve të ngushta ndërmjet dy gjuhëve dhe kulturave, duke përfshirë histori, letërsi, gjuhësi, antropologji, spiritualitet, sociologji, filozofi, arte etj. Në peizazhin e shtypit shqiptar të Rumanisë, gjatë gjithë historisë së pasur të këtij shtypi, kanë munguar revistat e profilit shkencor dhe universitar. "Albanica" mbledh rreth vetes të gjitha forcat shkencore universitare si dhe forcat krijuese përfaqësuese të letërsisë dhe artit shqiptar. Ajo u drejtohet elitave të Rumanisë, universitarëve dhe studiuesve të këtij vendi, të gjithë atyre që janë të interesuar për të njohur në mënyrë të thelluar kulturën dhe spiritualitetin shqiptar, përtej Shqipërisë së sotme, me historinë, antropologjinë, artin, gjuhësinë, letërsinë etj.

EKSPOZITA

# Nga Amsterdami në Shkodër, dinastia Marubi shfaq historinë

Fatmira Nikolli

Një ekspozitë me fotografi të përzgjedhura nga viti 1856 deri 1959, nga periudha osmane në atë komuniste, pa lënë jashtë fokusit as mbretërinë. Burra, gra, fëmijë, artistë, të burgosur, politikanë, njerëz të thjeshtë, peizazhe, zakone, rite, veshje, tradita.

Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" çel ekspozitën "Dinastia Marubi: Njëqind vite të studios fotografike shqiptare" e kuruar nga Kim Knoppers.

Ekspozita do të paraqesë një përzgjedhje imazhesh nga arkiva e Marubëve (1856- 1959) që kanë qenë pjesë e ekspozitës me të njëjtin titull të hapur në Muzeun e Fotografisë FOAM Amsterdam, më 2016.

Kjo ekspozitë vjen si një bashkëpunim me Muzeun e Fotografisë FOAM në Amsterdam, Holandë. Tanimë do të ekspozohen imazhe nga të gjitha trevat shqiptare. "Tre breza fotografësh kanë bërë portrete në studio të një shumëllojshmërie të gjerë njerëzish, duke filluar nga borgjezia urbane, te barinjtë, imazhe nga koha e Perandorisë Osmane dhe nga Mbreti Zog, te kriminelët, aktorët e artistët e famshëm dhe piktorët", raportohej atë kohë në sajtin e Muzeut të Fotografisë në Amsterdam. I pyetur për fotografitë e të burgosurve, Luçjan Bedeni pati thënë se "të burgosurit janë fotografuar ose në burgje, ose në studio e disa të tjerë kur është bërë regjistrimi i popullsisë". Në ekspozitë shfaqen imazhe artistësh si Tefta Tashko, Prek Jakova, Marie Kraja, bandat muzikore etj.



*Të burgosur e zengjinë, zonja dhe punëtore në imazhet e rralla*

"Ishte një kohë, diçka më pak se një shekull më parë, kur në Shqipërinë pa rrugë, pa transport, pa teatër, pa ekspozita, kishte shqiptarë që merrnin rrugën nga qoshe të tjera të vendit për të bërë një foto në studion 'Marubi' - këtë më rrëfente gjyshja ime nga Gjirokastra, tek më tregonte me krenari foton e saj e të gjyshit tim në fillim të viteve '30?, qe shprehur ish-ministrja Mirela Kumbaro në përurimin e muzeut, duke shtuar se: "Sot është koha kur duhet marrë avioni, trageti, apo makina, për të vizituar muzeun më të bukur të Fotografisë në Ballkan pa dyshim, por edhe me krenari do të thosha, një muze dinjitoz europian".

**KURATORJA**

Kim KNOPPERS është një historiane arti dhe kuratore në Muzeun e Fotografisë FOAM, Amsterdam. Që nga viti 2011, ajo ka punuan me ekspozitat personale të Melanie Bonajo, Adam Broomberg & Oliver Chanarin, Anne de Vries, JH Engström dhe Taiyo Onorato & Nico Krebs dhe ekspozita në grup si "RE-Search: Alumni Rijksakademie", "Collaborate: On Artists' Collectives" dhe "Back to the Future. The 19th century in the 21st Century". Ajo është e interesuar në zhvillime të ndryshme në fushën e fotografisë: që nga fotografia konceptuale tek artistët që punojnë me fotografinë dokumentare, nga materialet arkivore tek fotografia si mjet kërkimi. Në FOAM, ajo ka kuruar një sërë ekspozita mbi fotografinë historike në studio dhe vlerën e saj shoqërore dhe artistike. Knoppers është edhe themeluese e "Artists' Recipes", e cila eksploron lidhjen mes artit dhe ushqimit. Shkruan rregullisht për Foam Magazine si dhe për katalogë e libra artistësh. Jeton dhe punon në Amsterdam dhe fusha e saj studimore lidhet kryesisht me zonat e ish Perandorisë Osmane.

**MARUBËT**

"Rreth vitit 1850, jo shumë kohë pas shpikjes së fotografisë, italiani Pietro Marubi arriti në Shkodër, pjesa veriore e asaj që sot është Shqipëri. Aty ai ngriti studion e parë fotografike në rajon. Pas vdekjes së Pietros, asistenti i tij, Keli mori mbiemrin Marubi edhe si nderim për të. Ai e mbajti studion hapur dhe ia kaloi të birit, Gegë Marubit",- shkruhet në sajtin e muzeut holandez. Po aty, shënohet se "koleksioni me 150.000 xhama negativësh është interesant nga ana historike, sociologjike, kulturore dhe antropologjike e po ashtu nga ana artistike. Ngjarje nga historia e trazuar e Shqipërisë - nga periudha otomane te periudha komuniste, ritet sociale, kostumet folklorike dhe portrete grupesh të rëndësishme sociologjike mund të gjenden të gjitha në koleksion. Ekspozita është një prezantim i pasur i historisë së fotografisë të një vendi të izoluar europian". Pas çeljes së muzeut, një sërë sajtesh të huaja i kanë kushtuar vëmendje. Një artikull për muzeun "Marubi" është publikuar nga "Architizer", databaza më e madhe e arkitekturës dhe shtëpia e "A+Awards" - programi çmime globale për arkitektët më të mirë sot. Një tjetër artikull është bërë nga revista italiane e arkitekturës 'DIVISARE', si edhe nga Agjencia Ndërkombëtare të Lajmeve spanjolle EFE, nga revista e rëndësishme e arkitekturës "gooood.hk", si edhe një publikim nga prestigjiozja e arkitekturës në botë, revista "Dezeen", e cila është përqendruar te projekti arkitektonik i "Marubit".

## NDAHET NGA JETA NË MOSHËN 102-VJEÇARE AKADEMIK IDRIZ AJETI

Ka ndërruar jetë më 13 shkurt 2019 në Prishtinë, në moshën 102 vjeçare, albanologu, gjuhëtari e intelektuali, pedagogu dhe veprimtari i palodhshëm në zhvillimet tona shoqërore, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kryetar i saj në dy mandate, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Idriz Ajeti. Dijetar e erudit, personalitet shkencor, pa kontributet e të cilit studimet albanologjike në Kosovë e më gjerë nuk do të ishin këto që janë sot, akademik Ajeti ishte dhe mbetet njëra nga figurat më të ndritshme të historisë sonë të re. Lindi në Tupallë të Jabllanicës së Epërme, me 27 janar 1917. Shkollën fillore e kreu në Banjë të Sijarinës, të mesmen në Shkup, më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Zagrebit, në Degën e Gjuhës e të Letërsisë gën e Romanistikës. Studimet i mbaroi pas lufte, më 1949 në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Deri në vitin 1953 ishte profesor i gjuhës shqipe në Gjimnazin e Prishtinës. Në vitet 1953-1960 punoi lektor në Degën e Albanologjisë në Beograd. Në vitin 1958 u doktorua me temën: "Zhvillimi historik i së folmes gege të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë".

Nga viti 1960 ka dhënë mësim në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Prishtinës, një herë docent, pastaj profesor inordinar dhe nga viti 1968 profesor ordinar. Fushat kryesore të interesimit të tij shkencor kanë qenë studimet e dialekteve nga pikëpamja diakronike, raportet e shqipes me gjuhët fqinje, në rrafshin e studimeve ballkanologjike, trajtimi i dokumenteve të hershme gjuhësore, shkruar me alfabet arabo-turk etj. Është marrë dhe me çështje të gjuhës së sotme shqipe dhe ka organizuar takime e konsulta gjuhësore për të kërkuar zgjidhjet e përhershme rreth njësimit të gjuhës shqipe. Prof. Ajeti ka merita të veçanta në proceset e standardizimit të shqipes. Veprimtaria e tij shkencore është e gjerë dhe e gjithanshme. Ka botuar: Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, (1960), Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra (1961), Hymje në historinë e gjuhës shqipe (1963), Ortografia e gjuhës shqipe (bashkautor) (1964), Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike), (1969), Probleme të historisë së gjuhës shqipe, (1971), (zgjodhi e mbarështroi), Studije iz istorije albanskog jezika (1982), Studime gjuhësore në fushë të shqipes I, (1982), II (1985), III, IV (1989), Shqiptarët dhe gjuha e tyre (1994). Në Prishtinë, Tiranë e gjetiu janë botuar vëllime me studime të zgjedhura të tij. Ka hartuar tekste shkollore për nxënës të shkollave të mesme e studentë të Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe.

Në vitet 1997-2002 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës botoi veprën e tij të plotë në pesë vëllime. Në bibliografinë e tij gjejmë qindra artikuj, studime, kumtesa të mbajtura në Konferenca shkencore, seminare, takime kombëtare e ndërkombëtare, të botuara në revista e periodikë në shqip, por edhe në gjermanisht, frëngjisht apo në gjuhë të tjera. Me nismën e tij, si shef i Departamentit të Gjuhës Shqipe pas hapjes së Fakultetit në Prishtinë (1960), u nxor revista shkencore "Gjurmime albanologjike" (1962) e më 1974 u organizua Seminari i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare për të huaj.

Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, më 1971-73 dekan i Fakultetit Filozofik, në vitet 1973-75 rektor i Universitetit të Prishtinës.

Akademia e Shkencave në Shqipëri ka shprehur ngushëllimet më të thella për familjen, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe mbarë komunitetin akademik në Kosovë, Shqipëri e kudo ku jetojnë e punojnë shqiptarët.

Opinioni i Ditës

# Greta Thunberg dhe rinia për klimën

Nga Jorgji Kote

... po merr formë në Evropë, SHBA, Australi dhe gjetkë. Gjithçka filloi gushtin e kaluar, kur pas zjarreve shkatërrimtare në Suedi, ajo filloi të dilte çdo ditë në krye të qindra e mijëra shoqeve dhe shokëve në protestat përpara godinës së Parlamentit suedez, duke kërkuar me zë të lartë masa urgjente për klimën, sipas sloganit "O tani, o kurrë"! Pas zgjedhjeve të shtatorit të kaluar, këto grumbullime në Stokholm dhe gjetkë zhvillohen çdo të "Premte të klimës".

Vajza e vetme e një aktori dhe sopranoje, Thunberg u bë e famshme me fjalimin e saj plot pathos dhjetorin e kaluar në Konferencën e OKB-së mbi Klimën në Katovicë, ku denoncoi dështimin dhe paaftësinë e elitave qeveritare.

Më 23 janar ajo foli dhe në Forumin Botëror të Davosit, ku lëshoi sërish akuza ndaj elitave të biznesit për gjendjen e krijuar dhe lëshoi kushtrimin për veprim energjik. Madje, ajo theksoi që "nëse ai e bën të pamundur këtë mision, le ta ndryshojmë edhe vetë sistemin".

Por "Malalën e klimës", siç e quajnë, nuk e kanë bërë të famshme vetëm oratoria dhe fjalët e bukura. Greta bashkë me familjen jep shembullin e para në jetën ekologjike dhe të gjelbër që bën. Kështu, ajo shkoi në Davos me tren në një udhëtim që zgjati 32 orë në shenjë proteste ndaj 1500 Jet-eve private të elitave qeveritare biznesit! Ajo i ka kufizuar në minimum edhe fluturimet me avion të prindërve vetë jashtë Evropës. Kudo ku shkon, fle në çadra dhe thjeshtë, shpenzon pak dritë, konsumon ushqime me fare pak mish dhe proteina, që nuk dëmtojnë mjedisin etj.. Dhe sërish thotë se kjo është vetëm fillimi dhe shumë pak përballë një gjendjeje katastrofike të ngrohjes së klimës.

Veç disa medaljeve dhe çmimeve prestigjioze, dhjetorin e kaluar revista "Times" e renditi Greta Thunberg ndër 25 të rejat më me ndikim në botë. Kësisoj, ajo u bë shumë shpejt pikë referimi dhe burim frymëzimi dhe nxitjeje për rininë jo vetëm në Suedi, por edhe në shumë vende të tjera. Këtu po ndalemi në shembullin e spikatur të Gjermanisë dhe të Belgjikës, ku lëvizja për klimën është përshkallëzuar ndjeshëm.

Në shtetin me 12 milionë banorë të Bavarisë, në zgjedhjet e zhvilluara shtatorin e kaluar, Të Gjelbërit me lideren e re karizmatike 33-vjeçare Catharina Schulz dolën për herë të parë forca e dytë më e madhe politike me 20 për qind, duke prishur për herë të parë supremacinë e kristian-demokratëve të CSU-së; kryesorja, aty dhe në Hessen ata i çuan nga fundi i "tabelës" ekstremistët e AfD-së me shumë pretendime në shtetin më të pasur gjerman. Dhe në nivel federal, të Gjelbërit renditen pothuajse të dytët. Nën shembullin suedez, në disa qytete gjermane po zhvillohen me pjesëmarrje në rritje "Të premtet e klimës" me demonstrime dhe protesta paqësore.




Dhe më e fuqishme është bërë lëvizja "Rinia për klimën" në Belgjikë, ku në krye të saj janë dy "Greta". E para, në Rajonin e Flandrës, studentja 17- vjeçare Anuna De Wever që nga 10 janari udhëheq çdo të enjte protestat e nxënësve/studentëve në atë rajon. Ndërsa në jug, në Valoni lidere është 20-vjeçarja, Adelaide Charlier.

14 shkurti do të jetë e enjtja e gjashtë radhazi dhe më e madhja për klimën në Bruksel dhe në çdo qytet tjetër belg. Këtë të enjte ajo fillon dhe në Holandë e me siguri në javët e ardhshme dhe gjetkë në Evropë.

Ajo që bie në sy krahas pranisë masive në këto manifestime është karakteri shumë paqësor, larg zhurmës, incidenteve dhe dhunës, krejt i ndryshëm nga ai i "jelekëverdhëve", që janë zvenitur përpara entuziazmit dhe frymës vitale të rinisë shkollore e studentore. Është vërtet kënaqësi të shohësh në Bruksel dhe gjetkë mijëra të rinj e të reja me këngë, parulla dhe pankarta në duar tek marshojnë paqësisht nëpër sheshe e rrugë me thirrje entuziaste për qeverinë dhe biznesin. Këtë habi dhe simpati e shprehu dy javë më parë dhe vetë Drejtorja e Përgjithshme e Programit të OKB për Mjedisin Joyce Msyua teksa ndodhej në Bruksel. Këtë jehonë po e përcjellin dhe shumë personalitete të larta të artit dhe kulturës, si ylli hollivudian Leonardo Di Caprio, etj.

Lëvizja e re belge ka fituar menjëherë përkrahjen e gjerë politike publike dhe qeveritare, duke filluar nga Mbreti i Belgjikës. Tipar tjetër specifik është se atë po e mbështetin pothuajse të gjithë ekspertët e klimës e mjedisit dhe komuniteti akademik. Ditët e fundit, Aleancën "Rinia për klimën" e kanë mbështetur me një letër publike drejtuar Parlamentit, qeverisë dhe pushtetit lokal 3500 kërkues, profesorë dhe akademikë belgë.

Për rrjedhojë, edhe forcat politike, qeveria dhe Parlamenti belg po veprojnë me shpejtësi në mbështetje të gjithanshme të kësaj lëvizjeje, pa pritur shtimin e numrit të pjesëmarrësve dhe acarimin e saj; sepse e rëndësishme këtu nuk është numri, por përmbajtja e mesazheve që po jep rinia shkollore belge. Kështu, më 27 shkurt Ministria e Arsimit, veç lehtësive që ka krijuar për praninë masive në këto protesta dhe duke bërë përshtatjet e duhura për vijimin e procesit mësimor do të organizojë takime me përfaqësitë studentore dhe grupe ekspertësh të caktuar nga qeveria për të konkretizuar kërkesat e rinisë për klimën. Sapo kanë filluar dhe debatet në parlamentet lokale me drejtuesit e lëvizjes "Rinia për klimën".

Ndërkohë, Partia e të Gjelbërve në bashkëpunim me profesorë dhe akademikë të disa universiteteve ka hartuar një projektligj special mbi klimën, i cili po diskutohet me urgjencë në Parlamentin federal belg. Veç të tjerash ky ligj parashikon që deri në vitin 2030 të reduktohen 65 për qind e gazrave karbonikë, dy herë më shumë dhe 10 vjet më shpejt se parashikimi fillestar.

Dukuria tjetër dalluese e protestave masive "Rinia për klimën" është se nuk bëhet më fjalë thjesht dhe vetëm për masa, reforma apo arnime, ca më pak kozmetike, por për ndryshimin e gjithë sistemit të ligjeve/rregullave, mënyrës së jetesës, zakoneve të të ushqyerit dhe modeleve të konsumit, veshjet, argëtimi, mjedisi, transporti, praktikat komerciale, etj. Se sa serioze është gjendja mjafton të citojmë të dhënat zyrtare sipas të cilave prodhimi i artikujve ushqimore në botë zë 40 për qind të tokës dhe konsumon 70 për qind të ujit!

Ndaj, tani në Belgjikë po përmendet gjithnjë e më shpesh për fillimin e epokës së re të "tranzicionit ekologjik", si prelud i një shoqërie të re të gjelbër që deri në fund të këtij shekulli të shmangë detyrimisht ngrohjen globale mbi kufirin 1,5-2 gradë.

Natyrisht, siç pohojnë shumë ekspertë, kjo nuk është aq e lehtë sa duket. Krijimi i këtij sistemi të ri eko-shoqëror kërkon shumë kosto dhe sakrifica për shoqëritë shumëkombëshe, komunitetin e biznesit, sistemin arsimor, edukativ, atë financiar, të infrastrukturës dhe për vetë politikën; ajo do të hapë fronte të mëdha për të gjitha qeveritë dhe shoqërinë civile. Ndaj, rezistenca ka filluar qysh tani sidomos në veriun belg. Ditët e fundit dha dorëheqjen ministrja e Mjedisit e Rajonit të Flandrës, Joke Schauvliege e konsideruar "lokomotivë zgjedhore" e Partisë së moderuar CD&V. Kjo për shkak të skandalit që krijoi duke e konsideruar "komplot" "Lëvizjen për Klimën" e duke mashtruar se këtë ia kishte konfirmuar dhe Autoriteti Federal i Sigurisë Shtetërore! Ndërsa, disa ditë më parë, lideri i asaj partie deklaroi se pas Anuna de Wever është organizata "Green Peace" që kjo e fundit dhe aktivistja e shquar flamande e hodhën kategorikisht poshtë.

Kjo lëvizje e re në prag të zgjedhjeve evropiane është lajm i keq, u prish humorin dhe u rrëmben votat forcave populiste dhe ekstremiste. Axhenda e re e klimës nuk mund të "përtypet" e ca më pak të "gëlltitet" prej tyre, sepse "tranzicioni dhe shoqëria e re ekologjike" bën të domosdoshëm bashkëpunimin shumëpalësh, duke evidentuar dhe më dukshëm rolin e OKB-së, Bankës Botërore, BE-së, Traktatin Botëror të Klimës etj., që ata i kanë "halë në sy". Ata nuk duan ta kuptojnë se asnjë shtet apo grup shtetesh të vetme, sado të fuqishme, nuk mund të përballojnë dhe t'u japin përgjigje sfidave serioze dhe planetare të klimës dhe ngrohjes globale.

Gjithashtu, filozofia dhe veprimi për klimën bien në kundërshtim me mentalitetin e tyre. Populistët dhe euroskeptikët dinë dhe duan vetëm të mohojnë, por jo të pohojnë, të flasin, por jo të veprojnë, sidomos për zgjidhje tërësore afatgjata.

Nga ana tjetër, këto aleanca dhe zhvillime të reja të favorshme janë "ushqim për mendim dhe veprim" për BE-në, për të përshpejtuar dhe intensifikuar nismat për një " Kontratë të Re të Gjelbër" (New Green Deal) që ajo të bëhet nismëtare e shoqërisë së re të gjelbër. Veçse jo sipas avazit të vjetër, vetëm me projekte, reforma, shkurtime dhe shtrëngime, por duke e shoqëruar procesin me masa lehtësuese dhe favorizime financiare për masat e gjera të popullsisë, që ato t'ia ndiejnë lezetin dhe t'i thonë me plot gojën "Po" tranzicionit ekologjik.

Shembull nxitës dhe motivues në këtë fushë po jep me aktivitetin e saj të gjallë këtë fushë në SHBA senatorja më e re demokrate, 29-vjeçarja Alexandria Ocasio - Cortez, që ka propozuar "Kontratën e re të Gjelbër" (New Green Deal) me 5 qëllime, 14 projekte dhe 25 kërkesa madhore që përfshijnë të gjitha fushat. Gjithsesi, aty theksi vihet te njerëzit, hallet e tyre, punësimi, pagat, niveli i sigurimit e pastaj te teknologjia. Kjo "Kontratë e re e Gjelbër" kërkon drejtësi mjedisore, energji të pastër dhe jo të rinovueshme, tatime me 70 për qind mbi të ardhurat mbi 10 milionë dollarë amerikanë, një shtet social etj.

Vetëkuptohet se kur për ekologjinë dhe mjedisin po shqetësohen seriozisht vende të tilla të përparuara si Suedia, Gjermania, Belgjika etj. në Shqipëri problemet janë shumë më të mprehta dhe se interesi/intensiteti i veprimit tonë as që mund të krahasohet me ato vende. Veç kësaj, klasa jonë politike është e zënë me probleme të vjetra që ka dështuar t'i zgjidhë në tri dekada, madje duke u shtuar dhe kriza të tjera që ka krijuar, me dashje ose pa dashje. Për pasojë, rrezikohemi të mbetemi të fundit dhe në këtë aspekt madhor që ka të bëjë me brezat tonë të ardhshëm dhe jo me ideologji të caktuara. Sepse klima dhe mjedisi nuk janë as të majtë dhe as të djathtë, por vërtet gjithëpërfshirëse. Krejt ndryshe nga fushatat zgjedhore dhe lëvizje të tjera madhore, siç shprehen yjet e lëvizjes së re rinore, me klimën dhe mjedisin fitojmë ose humbasim të gjithë dhe përgjithmonë.

Opinioni i Ditës

# Për taksa pa stërkëmbësha

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*



... jo vetëm ecurinë e investimit, por rrezikon të çojë në faliment biznesin që ka riskuar paratë në atë investim!". Ligji "Për procedurat tatimore" i 19 majit të vitit 2008 është ndryshuar(arnuar) 157 herë në 10 vjet deri tani! Sa herë ndryshohen rregullat e lojës në pagimin e taksave, aq herë bëhen konfuzë dhe çoroditen ata që duan të jenë në rregull me detyrimet ndaj shtetit, thotë Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe në misionin e fundit në nëntor 2018, FMN paralajmëroi qeverinë për dëmet në ndryshimet në ligjin themelor të taksave, që është ligji i mësipërm, në paketën fiskale për Buxhetin e shtetit të vitit 2019. Vetë ligji "Për procedurat tatimore" ka 137 nene dhe është ndryshuar 157 herë! Imagjinoni çfarë absurdi. Janë prekur 78 nene bazë, themelet e vetë ligjit. Kjo ka sjellë një gjendje ku sjellja e organeve të mbledhjes së taksave tek ne nuk mund të parashikohet më, jo për katër vjet, por as për katër muaj. Përtej qëllimit që kanë ndryshimet gjithnjë e më të shpeshta në këtë ligj, nganjëherë edhe kontradiktore me njëra-tjetrën, ata që paguajnë taksat, në sipërmarrje të mëdha apo të vogla qofshin, nuk po i përballojnë dot ndryshimet e shpeshta. Nuk arrijnë dot t'i respektojnë, sado vullnetmirë e syçelët të tregohen. Kjo ka prodhuar në shumë raste gjoba pa mbarim, që vijnë nga moskuptimet e ligjeve dhe mosdalja në kohë e udhëzimeve për administratën tatimore. Rrëmujën e ka shtuar kapja e shtetit për interesa të grupimeve të caktuara të biznesit. Në 12 vitet e fundit, janë me dhjetëra Vendimet e Këshillit të Ministrave(VKM-të) dhe madje edhe disa ligje të caktuara, që kanë favorizuar kompani të veçanta. Ka pasur raste kur janë ndryshuar kriteret e licencimit dhe magazinimit për një industri të tërë, në varësi të interesit për të licencuar një kompani të re që ka lidhje me grupime të caktuara politike apo për të vështirësuar mbijetesën e një kompanie që është tashmë në treg. Rastet e kapjes së shtetit janë pa fund. Tre vjet më parë, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave në Kuvend rrëzoi një propozim absurd të Ministrisë e Financave për të përjashtuar pijet energjike nga akciza. Kjo politikë e veçuar në shërbim të pak kompanive dhe për një mall konsumi luksi shkonte përpjetë politikës së rritjes së akcizës që ka ndërmarrë gjithë këto vite qeveria me mallrat e tjera. Po tre vjet më parë, në kulmin e forcimit fiskal, kur rritja e taksave vërshoi pothuajse në të gjithë zërat, qeveria hoqi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-në) për sigurimet, duke e zëvendësuar atë me tatimin 3% për primin(çmimin e sigurimit) bruto. Ky ndryshim, megjithëse u miratua në Kuvend, kaloi me debate të ashpra në komisionet parlamentare. Ligji ishte bërë qartazi për të favorizuar kompanitë e sigurimeve. Ai nuk solli përfitime as në çmime më të lira për konsumatorët e shumtë të sigurimeve (sidomos ata të mjeteve motorike janë mbi 500 mijë!), as në të ardhura më të larta për Buxhetin e shtetit. Në fakt, tre vjet pas këtij ndryshimi skandaloz, lehtësimi tatimor mbi kompanitë e sigurimit nuk funksionoi as për qytetarët dhe as për arkën e shtetit. Nga ana tjetër, shumica e koncesioneve të dhëna që nga vitit 2008 dhe e koncesioneve të fundit me formulën partneritet publik-privat janë ofruar si shpërblesa ndaj bizneseve të lidhura ngushtë me politikën. Në praktikat ndërkombëtare, sidomos në vendet e Bashkimit Evropian, kjo dukuri(kapja e shtetit në këtë farë feje) jo vetëm që është e dënueshme, por vendet e BE-së dhe SHBA-të kanë miratuar legjislacion shtesë, në mënyrë që të parandalojnë lindjen dhe zhvillimin e këtyre qasjeve korruptuese. Tek ne, gjithçka do të ndryshojë për mirë, nëse shpluhuroset projektligji i ri për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i cili ka mbi tre vjet që pret në raftet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. E kishte përgatitur ministri që u silurua pas gurgulesë me mbledhjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga një ofertë e pakërkuar e një kompanie të huaj nga Hong-Kongu. Nëse miratohet ky ligj dhe futet Kodi Fiskal si kuptim dhe praktikë në legjislacionin tonë tatimor, marrin fund qindra stërkëmbëshat ligjore që u kemi vënë në këto 11 vjet qindra mijërave shqiptarëve që duan të paguajnë korrekt taksat në këtë vend.




## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje, që janë në një lidhje do të kalojnë një ditë shumë të këndshme dhe plot emocion. Ndërsa beqarët sugjerohet që t'i kushtojnë vëmendje paraqitjes së tyre dhe t'i japin asaj sa më shumë shkëlqim.

### DEMI

Sot do të përjetoni gjëra të reja. Është e rëndësishme t'i kushtoni vëmendje suksesit dhe më pas do t'ju ndjekë edhe fati. Ka gjasa që të përballeni me disa probleme në lidhjen tuaj. Sot mund të nisë edhe një luftë për lidership në punën tuaj.

### BINJAKET

Ka gjasa që sot t'i bëheni barrë dikujt. Mbajini të sigurta sekretet tuaja dhe mos u tundoni t'i tregoni ato. Gjithashtu, mos harroni njerëzit e afërt, të cilët presin vëmendje nga ana juaj.

### GAFORJA

Do të tregoheni të tërhequr nga pjesa tjetër e kolektivit. Ndoshta do të jeni të shpërqendruar për shkak të lidhjes suaj romantike. Ka gjasa të zhvilloni një bisedë befasuese me dikë, që nuk flisni shpesh. Mbrëmjen do të ishte mirë që t'ia kushtonit vetes suaj.

### LUANI

Do të përballeni me një problem të vogël në familje për shkak të një keqkuptimi. Edhe në punë mund t'ju krijohet një situatë e tensionuar. Megjithatë, mbrëmja do të jetë më e qetë dhe do të ishte mirë t'i përkushtoheshit romancës.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje do të shprehin sot iniciativat e tyre për të ardhmen. Këtu mund të përfshihet një profesion i ri ose një projekt biznesi. Fati i mirë do të ndjekë ata që janë të angazhuar në një fushë kreative.

### PESHORJA

Dita e sotme do të mbetet gjatë në kujtesën tuaj. Do të kaloni momente shumë të bukura me të afërmit tuaj. Megjithatë, kjo nuk duhet t'ju shpërqendrojë nga puna aktuale. Mund t'ju besohet një projekt i ri ose mund t'ju japin përgjegjësi të reja në punë.

### AKREPI

Akrepët do të kenë disa ide brilante, por bëni kujdes kur t'i shprehni ato pasi duhet të jeni me këmbë në tokë. Në përgjegjësi, kjo e enjte do të kalojë mirë, me lehtësi dhe me rezultate produktive. Përpiquni të shmangni egoizmin.

### SHIGJETARI

Për disa Shigjetarë, 14 shkurti do të mbahet mend si një ditë shumë e lumtur. Madje, mund t'ju vijë një suprizë e mrekullueshme. Bëni kujdes nga disa persona të afërt që iu rrethojë. Mendojini mirë këshillat që ata mund t'ju japin.

### BRICJAPI

Përpiquni të gjeni kohë për tu relaksuar. Kjo do të jetë shumë e nevojshme si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Do të ndiheni të lodhur nga informacionet e tepërta. Kaloni më shumë kohë më fëmijët, shijoni natyrën ose bëni një shëtitje në ajër të pastër.

### UJORI

Për Ujorët 14 shkurti do të kalojë në qetësi. Do të keni mundësi të shënoni rezultat në biznes ose të zgjidhni një problem serioz në familje. Në mbrëmje do të zhvilloni një takim të rëndësishëm.

### PESHQIT

Peshqit do të tregohen egoistë gjatë ditë së sotme. Përpiquni t'i kushtoni më shumë vëmendje çështjeve me rëndësi. Këtë të enjte ka gjasa të zgjidhni edhe një ngërç financiar ose të zgjidhni një mosmarrëveshje me një prej kolegëve tuaj.

PORTIERI I KUKËSIT

## Frashëri: 8 pikë nuk janë shumë, do t'i rikuperojmë



Tetë pikë larg Partizanit, por te Kukësi janë optimistë dhe besojnë shumë. Në Durrës luhet sezoni dhe te kuksianët këtë e dinë të gjithë. Në një prononcim që ka dhënë "gardiani" Stivi Frashëri, i skuadrës së Kukësit ka pohuar: "Jemi fokusuar te ndeshja e radhës që do të luajmë në Durrës. Teuta ka një ekip shumë të mirë. Edhe për atë rezultat në ndeshjen e fundit, duhet që të sakrifikojmë dhe duhet që të marrim 3 pikët". Frashëri, ndër të tjera u ndal edhe te forma e kundërshtarit: "Nuk është se e shohim veten favorit, por ne na duhet që të bëjmë më të mirën në çdo ndeshje. Do të bëjmë maksimumin për të marrë sa më shumë në fushë. E nisëm pak me këmbën e gabuar, por besoj se edhe ardhja e lojtarëve të rinj ka problematikën e vet në ambientim. Megjithatë duhet që të shohim përpara. Është një distancë e rikuperueshme ndonëse janë 8 pikë. Megjithatë ka edhe 15 ndeshje. Tashmë duhet që në çdo ndeshje që luajmë duhet që të bëjmë më të mirën dhe të japim më të mirën në secilën prej takimeve që kemi përpara". Në fund, Stivi Frashëri foli edhe për aktivizimin dhe këtë sezon që sipas tij është nga më të suksesshmit: "Besoj se është viti më i mirë, por jo për aftësitë e mia. Kukësi ka një mbrojtje mjaft të mirë. Po çedojmë pak përpara, sepse në sulm nuk shënojmë ndonëse krijojmë shumë raste. Mesfusha dhe sulmi duhet që të bëjnë më të mirën", - tha Stivi Frashëri në fund të fjalës së tij.

AUSTRIAKËT

## Ikardi nuk luan, Rapidi është në festë

Vendimi i klubit të Interit ditën e djeshme, për t'i hequr shiritin e kapitenit Mauro Ikardit, si dhe fakti që u la jashtë ndeshjes së nesërme në Europa League ndaj Rapidit të Vjenës, ka shkaktuar një furtunë të vërtetë. Këtë situatë, e ka shfrytëzuar edhe trajneri i austriakëve, Ditmar Kuhbauer, i cili në konferencën për shtyp në vigjilje të sfidës, gjen kohë edhe për humor. "Interi është një skuadër që vlen rreth 600 milionë euro, por në fushë nuk luajnë paratë. Është shansi ynë i madh, si dhe qëllimi ynë të rrëzojmë në gjunjë, një kundërshtar të madh, edhe pse e dimë se duhet të japim gjithçka. Jetojmë për ndeshje të tilla. Qartazi jemi ekip i dorës së dytë, por në futboll kurrë nuk i dihet. Ikardi mungon? Epo nëse ai nuk është në fushë, jemi ne favoritët (qesh). E rëndësishme është të kuptojmë se si do luajë kundërshtari. Jemi të fokusuar tek Interi, dhe jo tek individualitetet në fushë" - deklaroi trajneri i Rapidit të Vjenës, Ditmar Kuhbauer.

Argjentinasi s'është pajtuar me vendimin dhe ka vendosur të mos grumbullohet për ndeshjen ndaj Rapidit

# Interi i heq shiritin e kapitenit, Ikardi s'udhëton me ekipin në Vjenë

## *Portieri Handanoviç do të jetë kapiteni i ri zikaltër*



Jeton Selimi



Një "tërmet" i vërtetë në shtëpinë e Interit: Mauro Ikardi nuk është më kapiten i ekipit. Me anë të një postimi në faqen e tyre zyrtare, klubi ziklatër ka bërë publik këtë vendim, me shiritin e kapitenit që tashmë i kalon portierit Samir Handanoviç. Një vendim i bujshëm i drejtuesve të klubit i ardhur pikërisht në momentin më të nxehtë ku diskutimi mbi rinovimin e tij është kthyer në një çështje shqetësuese. Ikardi po kalon momentin më të vështirë që nga periudha kur ka veshur fanellën ziklatër, heqja e shiritit pritet të sjellë një reaksion të madh. Pas këtij vendimi tifozët ziklatër janë të gjithë sy e veshë për të dëgjuar reagimin e Ikardit dhe sigurisht bashkëshortes së tij Vanda Nara. Më këtë lëvizje nuk bëhet fjalë më për rinovimin e tij, më shumë pritet të diskutohet nëse Ikardi do të qëndrojë sërish tek Interi pas përfundimit të këtij sezoni. Në një kohë kur Spaleti kërkonte një zgjidhje të shpejtë për çështjen "Ikardi", drejtuesit e klubit i janë përgjigjur më këtë vendim surprizë, i cili me shumë gjasa do të çojë palët drejtë një divorc të pashmangshëm. Drejtuesit e Interit, por edhe trajneri Spaleti nuk e kanë toleruar aspak fryrjen e situatës së mungesës së rinovimit nga ana e bashkëshortes-menaxhere, Vanda Nara, e cila nuk ka lënë rast pa thumbuar klubin zikaltër. Sjellja e Ikardit ka shkaktuar acarim brenda dhomave të zhveshjes dhe Spaleti nuk ka mundur dot ta durojë diçka të tillë, teksa ka gjetur dhe mbështetjen e drejtorit Marota. Konferenca e djeshme e Luçano Spaletit pritej me kërshëri të madhe. Ndeshja e sotme ndaj Rapidit të Vjenës kaloi në plan të dytë, pasi zhvillimet e fundit në shtëpinë zikaltër kanë zgjuar interesin e të gjithë botës sportive. Spaleti ka sqaruar dënimin e Mauro Ikardit, por siç e thekson trajneri toskan, kjo është bërë për të mirën e Interit "Vendimi për heqjen e shiritit ishte diçka e vështirë dhe dhimbshme, por për të mirën e Interit. Ai nuk është i grumbulluar pasi nuk donte të vinte me ne dhe qëndroi në shtëpi. Ai u ndje shumë keq për këtë, por dhe për ne ishte shumë e vështirë. Vendimi u mor në kohën e duhur, sepse gjerat rreth tij, shqetësonin atë dhe të te tjerët rreth tij. Tashmë duhet ta kemi të gjithë mendjen te Rapidi".

## Edhe Çelsi e Junajtid, në gjurmët e Dibalas

Argjentinasi i Juventusit nuk po kalon një periudhë të mirë te bardhezinjtë. I zhvendosur shumë prapa në skemat e Alegrit, numri 10 nuk është aspak i kënaqur dhe e ka shprehur këtë, aq sa në sfidën e fundit ndaj Sasuolos, e nisi nga stoli. Situata e tij ka bërë që të shtohen zërat për një largim të mundshëm. Përveç Realit të Madridit, që ka shfaqur prej kohësh interesin e tij për yllin argjentinas, vijnë dhe raportime të tjera. Sipas "The Sun", Çelsi dhe Mançester Junajtid janë të gatshëm për plotësuar kërkesat e Juventusit për ta lënë të lirë Dibalan. Ndërkohë, sërish sipas "The Sun", bardhezinjtë nuk kanë hequr dorë nga Salah, për të cilin janë të gatshëm të ofrojnë para dhe argjentinasin.

Shkodrani është kalimtar në Durrës

## Vajushi: Erdha te Teuta që të iki prap jashtë

Armando Vajushi ka ardhur me qëllimin që të shkëlqejë në Durrës e më pas të kalojë sërish në një ligë më të fortë. Shkodrani, që sezonin e shkuar ka qenë pjesë e Pro Verçelit, tani duhet të djersijë me fanellën e Teutës dhe të japë maksimumin deri në fund të kampionatit. "Të them të drejtën, për 7 vite kam qenë jashtë. Në Shqipëri isha në bisedime me shumë ekipe, por në fund zgjodha të vij te Teuta, pasi ishte vendi i vetëm ku më kërkuan me ngulm. Drejtuesit më thanë se do më siguronin çdo gjë, dhe vendosa të vij këtu pasi më kërkuan me zemër.



Këto katër muaj, kam si synim të luaj e të ndihmoj ekipin, si dhe të arrij objektivin personal, të iki sërish në një kampionat jashtë."

Sfidën e radhës, Teuta do ta luajë ndaj Kukësit në "Niko Dovana", një përballje direkte për vendin e dytë, ndaj shkodrani i skuadrës bregdetare kërkon suksesin. "Është një ndeshje e vështirë, por nuk do të thotë se vendos sezonin tonë, pasi nuk është ndeshja e fundit. Në fushë do të bëjmë maksi-

Ish-administratori i Milanit

## Galiani: Piatek-Paketa, si Sheva-Kaka



Adriano Galiani shqetësohet gjithmonë për Milanin. Tashmë në një post drejtuesi te Monza, është rikthyer të flasë për kuqezinjtë. Pjesa që atij i pëlqen të komentojë më është shumë është merkato, ku Milani ka afruar Paketën dhe Piontek. "Më pëlqen ky Milan, janë forcuar shumë në janar. Me Paketa e Piontek mund të luftojnë deri në fund për Championsin. Piontek më kujton Shevçenkon, e mendova menjëherë diçka të tillë, sapo e pashë. Ëndrra ime është që Piketa-Paketa të bëhen si Kaka-Shevçenko. Lojtarët kanë ndryshuar po Gatuzo ka luajtur me 4-3-3", përfundon Galiani.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Eshtë stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kufij
17. Parashtesë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Eshtë si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Eshtë me shumë se kërkesë.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të pritjes.
35. Gjysmë bataku.
36. Eshtë për medaljen e parë
37. Eshtë kujdesi i babait.
39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Eshtë këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kufij

VERTIKAL
1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Eshtë pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoque.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Eshtë thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'Istria e Helena Gjikës
12. Smith filozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Moduli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolete.
20. Mbyllí fushatat.
21. Eshtë dorëzim.
22. Eshtë detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Eshtë hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifilimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
33. E egër dhe e fortë.
34. Janë thëniet e famshme.
35. Janë trupa qiellorë të tillë.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në computer
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Eshtë e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Eshtë thesar.



VERTIKAL
1. E famshme ajo maqedonase.
2. Një zakon.
3. Bëjnë alarm me ar
4. Inicialet e Mallë regjisor
5. Mund të jetë telefonike
6. Ka dy faqe
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhen për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstreme në tunel.
21. Një atentator vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshtja e qengjave.
29. Eshtë aparati me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.
45. Në krye të armatës.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 5 | | 7 | | | | 9 | |
| 1 | | | | 3 | | | | |
| 9 | | | | 8 | | 6 | | |
| | 9 | | | | | 7 | | |
| | | | 8 | | | 2 | | |
| | 6 | 5 | 1 | | | | | |
| | | | | | | | | |
| 3 | | 9 | 6 | 1 | | | 8 | 4 |
| | | 2 | 5 | | 4 | | 7 | 6 |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 4 | 7 | 8 | 2 | 1 | 9 | 6 | 3 |
| 8 | 1 | 3 | 9 | 5 | 6 | 4 | 2 | 7 |
| 9 | 2 | 6 | 3 | 4 | 7 | 1 | 8 | 5 |
| 6 | 8 | 5 | 7 | 9 | 3 | 2 | 4 | 1 |
| 4 | 3 | 2 | 1 | 6 | 5 | 7 | 9 | 8 |
| 1 | 7 | 9 | 4 | 8 | 2 | 3 | 5 | 6 |
| 7 | 9 | 8 | 5 | 1 | 4 | 6 | 3 | 2 |
| 2 | 5 | 1 | 6 | 3 | 9 | 8 | 7 | 4 |
| 3 | 6 | 4 | 2 | 7 | 8 | 5 | 1 | 9 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Një nga liritë më të mëdha është të mos interesohesh në të vërtetë se çfarë mendojnë të tjerët për ju.

- Një stërvitje e mirë për zemrën, është të përkulesh dhe të ndihmosh dikë që të ngrihet.

- Jepi kohë tjetrit të kuptojë çfarë humbi... Jepi kohë vetes të kuptojë çfarë vlen!!!

- Çdo e keqe kujtohet, çdo e mirë harrohet.

- Kur Perëndia të jep miell, djalli të merr thesin.

- Ata që keni pranë, tregojnë karakterin tënd...Ata që le pas në të kaluarën, dinjitetin tënd.



## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME
*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | R | I | M | | S | M | | M | A | S | A | T |
| A | R | | B | E | | E | M | | L | I | M | A |
| K | | D | E | L | E | G | A | T | E | T | | L |
| | M | I | T | O | M | A | N | E | T | | D | E |
| K | O | M | U | N | I | T | E | T | E | T | | N |
| O | P | E | R | A | T | O | R | E | T | | F | T |
| M | | N | I | | E | N | O | | | G | A | |
| P | | S | N | | N | I | | M | A | L | L | I |
| A | M | I | A | N | T | | K | | | O | S | E |
| N | | O | T | | E | K | I | P | O | R | E | |
| I | T | N | | E | T | I | L | E | N | I | | E |
| A | L | I | B | I | | S | I | R | T | A | R | I |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)



Argëtim filozofik

## Thënie të mençura

- Nëse nuk mund të jesh lapsi që vizaton buzëqeshjen në jetën e atyre që do, atëherë bëhu goma që fshin vuajtjet e tyre.

- Para se të gjykosh jetën time, të kaluarën time, karakterin tim...
Vish këpucët e mia dhe shkel nëpër shtigjet që ka kaluar jeta ime. Jetoje me "shpirtin tim", me "dyshimet e mia", me "frikën time", me "dhimbjen time".
Dhe kur të keni jetuar jetën time, atëherë dhe vetëm ju jap të drejtën të gjykoni jetën time!!!

- Mos i thuaj Zotit se sa e madhe është fortuna që kalon...
Por thuaj fortunës se sa i madh është Zoti që beson...


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al